



REPUBLIKA E KOSOVËS

Komuna e Drenasit

Kuvendi i Komunës



02 Nr 060/03-61106 dt. 20/12/ 2023

Në bazë të nenit 43 të Ligjit nr. 03/L-40 për vetëqeverisje Lokale, neni 36,41 dhe 42 pika 42.2 të Statutit të Komunës së Drenasit (Gilloqocit), nenit 3 pika 3.7 si dhe nenit 12 pika 12.2 të Rregullores së punës të Kuvendit, Kryesuesi i Kuvendit të Komunës z. Milaim Hajdari, më datë: 27.12.2023 (E Mërkurë) duke filluar në ora 10:00 në sallën e Kuvendit të Komunës.

THËRRET

MBLEDHJEN E RREGULLT TË KUVENDIT TË KOMUNËS

Mbledhja do të ketë këtë:

Rend dite:

1. Procesverbali i mbledhjes së Kuvendit Komunal i datës 22.11.2023.
2. Propozim vendim për shpalljen e z. Hashim Thaqi "Qytetar Nderi" i Komunës së Drenasit.
3. Propozim vendim për shpalljen e z. Kadri Veseli "Qytetar Nderi" i Komunës së Drenasit.
4. Propozim vendim për shpalljen e z. Jakup Krasniqi "Qytetar Nderi" i Komunës së Drenasit.
5. Propozim vendim për shpalljen e z. Rexhep Selimi "Qytetar Nderi" i Komunës së Drenasit.
6. Plani i Punës së Kuvendit Komunal për vitin 2024.
7. Plani vjetor i punës së Kryetarit të Komunës për vitin 2024.
8. Lista e Rreziqeve Komunale për vitin 2024.
9. Propozim vendim për financim të projektit në projektin e Jehona Hoxha.
10. Propozim për ndryshimin/korrigjimin të vendimit për financimin e projektit Drilona Krasniqi.
11. Propozim për ndryshimin/korrigjimin të vendimit për financimin e projektit Sabahate Gashi.
12. Propozim për ndryshimin/korrigjimin të vendimit për financimin e projektit Doruntina Shehu.
13. Lista me anëtarët për Komitetin Konsultativ për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport i propozuar nga paneli përzgjedhës nga Kuvendi Komunal Drenas.
14. Lista me anëtarët për Komitetin Konsultativ për Zhvillim Ekonomik, Mbrojtje të Ambientit, Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale nga paneli përzgjedhës nga Kuvendi Komunal Drenas.

15. Lista me anëtarët për Komitetin Konsultativ për Komiteti për Personat me Aftësi të Kufizuar i propozuar nga paneli përzgjedhës nga Kuvendi Komunal Drenas.
16. Propozim për ndryshim-plotësimin e rregullores për taksa tarifa, ngarkesa dhe gjoba Nr. 02-400/01-57198 të datës 22.11.2023.
17. Raporti i ekipit të Auditimit Social në Drenas.
18. Raporti i vitit 2023 për aktivitetet e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi.
19. Raporti vjetor i punës për vitin 2023 i Komitetit për Komunitete dhe Kthim.
20. Raporti vjetor i punës për vitin 2023 për Komitetin Konsultativ për Barazi Gjinore.
21. Të ndryshme.

Drenas, 20.12.2023



Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

Milaim Hajdari



Republika e Kosovës
Komuna e Drenasit
Kuvendi i Komunës



02 Nr. 060/04-59769 dt. 12/12/ 2023

PROCESVERBALI

Të mbledhjes së rregullt të Kuvendit Komunal të Drenasit të Mbajtur më datë: **22.11.2023**
e cila filloi në orën 10:00.

Mbledhjen e kryesoi kryesuesi i Kuvendit Komunal-Milaim Hajdari

Kryesuesi deklaroi të hapura punimet e mbledhjes së rregullt të Kuvendit Komunal, ku të pranishëm ishin 30 anëtarë: Labinot Halilaj (PDK), Bekim Lestrani (PDK), Arigon Sinani (PDK), Zeqir Hasi (PDK), Laurita Muhadri Bujupi (PDK), Hamit Kastrati (PDK), Blerina Gashi (PDK), Gani Krasniqi (PDK), Fatmir Baliu (PDK), Qendrim Mulaj (PDK), Malsore Cakiqi (PDK), Blerina Gashi (PDK), Albulena Saliuku (PDK), Valentina Leku (PDK), Manushaqe Mulaku (PDK), Mirlinda Dvorani (PDK) Sali Dvorani (DD), Mergim Pirraku (DD), Mehedin Salihu (DD), Hamit Haxhiu (DD), Jahir Hajdari (DD), Azemine Bujupi-Gjoka (DD), Marigona Bazaj (DD), Florentina Elezi-Veliu (VV), Filloreta Bujupi (VV), Drin Halilaj (VV), Egzona Terrdevci (VV), Muhamet Kurtaj (VV), Arbër Halilaj (GREEN), Beqir Kiqina (AAK), Egzon Qorri (LDK). Sali Dvorani (DD). **Mungoi Arbër Halilaj.**

Të pranishëm ishin edhe **Kryetari i Komunës, Ramiz Lladrovci, Drejtor të Drejtorive komunale, përfaqësues të KFOR-it zyra e informimit, qytetar.**

Mbledhja filloi punimet me këtë rend dite:

1. Procesverbali i mbledhjes së rregullt i Kuvendit Komunal Drenas të dt. 27.10.2023.
2. Raport për zbatimin e Planit të Integritetit për Komunën e Drenasit për vitin 2023.
3. Raport për përfundimin e procesit të zgjedhjes së Këshillave Lokale në Komunën e Drenasit.
4. Propozim vendim për mbështetje financiare e Qendrës për Promovimin e të Drejtave të Grave.
5. Propozim për ndryshim-plotësimin e rregullores për taksa tarifa, ngarkesa dhe gjoba Nr.030/01-53502 të datës 27.10.2023.
6. Propozim vendim për formimin e Panelit Përzgjedhës për zhvillimin e procedurave për themelimin e Komitetit Konsultativ Komunal për Arsime, Kulturë, Rini dhe Sport.
7. Propozim vendim për formimin e Panelit Përzgjedhës për zhvillimin e procedurave për themelimin e Komitetit Konsultativ Komunal për Persona me Aftësi të Kufizuara.

8. Propozim vendim për formimin e Panelit Përzgjedhës për zhvillimin e procedurave për themelimin e Komitetit Konsultativ Komunal për Zhvillim Ekonomik, Mbrojtje të Ambientit, Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale.
9. Propozim vendim për plotësim ndryshim të vendimit të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi.
- 10 Propozim vendim për plotësim ndryshimin e nenit 7 të vendimit nr 02 463/05 53498 për dhënien në shfrytëzim afatgjatë për 99 vite, Pronën e Paluajtshme të Komunës me procedurë të negocimit të ofertës.
11. Të ndryshme.

Mbledhja e rregullt e Kuvendit të Komunës së Drenasit u mbajt me dt. 22.11.2023, ku për diskutim ishin 11 pika për rend dite. Mbledhja është kryesuar nga kryesuesi i Kuvendit Komunal Milaim Hajdari. Kryesuesi hapi punimet e mbledhjes së rregullt të Kuvendit Komunal ku njoftoi me rendin e ditës e lartcekur.

Egzona Tërdevci: propozoj që pika pestë mos shqyrtohet sot, arsyeja është se sipas Ligjit për Vetëqeverisje Lokale materialet për secilën pikë të rendit të ditës duhet të dorëzohen shtatë ditë para mbledhjes, ne nuk kemi marrë materialet me kohë dhe nuk konsideroj që është e arsyeshme ta trajtojmë këtë pikë.

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci: Jeni detyruar me trajtu këtë pikë të rendit të ditës, e keni trajtu, është krye, e keni vlerësimin e MAPL-së dhe jem të detyruar me e shqyrtu në këtë mbledhje, kemi ndryshu gjëra teknike, të cilat na i kanë propozu ministrinë e caktume.

Egzona Tërdevci: Po ashtu kam një vërejtje që e kam përcjellë me e-mail tek ju i nderuar kryesues tek ju zotëri Lladrovci, e kam përcjellë edhe të zotëri Arben Shala që ka qenë kryesues i komisionit, unë kam kërku që me u përditësua materiali i raportit që e ka dërgu për Këshillat Lokale nuk ka asnjë ndryshim në raporte, po e them që le të mbetet në procesverbal, sepse diçka që ju dërgohet paraprakisht me shkrim është dashtë me përfshirë në material.

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci: A e ke vetë Drinin pse s'ka ardhë me nënshkru raportin? E kanë pritë deri dje e nuk e kanë nënshkru raportin. Pra, dokumentet veç t'jua kujtoj përgjithmonë, nuk e ndërrojmë raportin që e ka bo komisioni pse e ke qu ti në e-mail, sepse unë nuk i bëj raportet. Nuk e bëj raportin unë, pra e bën ai që u kanë kryesues i komisionit.

Drin Halilaj: unë kam qenë dje dhe e kam nënshkru raportin.

Pas diskutimeve vërejtjeve dhe sugjerimeve që u dhanë kryesuesi hodhi në votim rendin e ditës me pikat e lartëcekura më lartë: prezent gjatë votimit ishin 29 anëtar, “Për” votuan 24 anëtar, kundër nuk pati, 4 abstenim, u miratua rendi i ditës.

Komunal, Milaim Hajdari- hapi diskutimin për pikën e parë të rendit të ditës: 1.

Procesverbali i mbledhjes së rregullt i Kuvendit Komunal Drenas të dt. 27.10.2023.

Egzona Tërdevci: Po më vjen keq se po e stërdiskutojmë këtë punën e procesverbalit, po kam pritë reflektim pas krejt vërejtjeve që i kam dhënë, edhe në seancë, edhe jo formalisht jua kam dhënë juve, edhe vetë zyrtarëve të Kuvendit, po ka ardhë koha që të shkruajmë shqip qysh shkruhet procesverbali.

Meqë nuk pati diskutime apo vërejtje tjera kryesuesi hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës: prezent gjatë votimit ishin 29 anëtar, “Për” votuan 22 anëtar, 4 vota kundër, 2 vota abstenim, u miratua procesverbali i mbledhjes së rregullt të KK i mbajtur më dt. 27.10.2023.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal, Milaim Hajdari- hapi diskutimin për pikën e dytë të rendit të ditës: **2. Raport për zbatimin e Planit të Integritetit për Komunën e Drenasit për vitin 2023.**

Shaban Dobra-Zyrtar, Komuna e Drenasit në pajtim me legjislacionin në fuqi për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit dhe Strategjinë Shtetërore kundër Korrupsionit për 2022, ka hartuar dhe miratuar Planin e Integritetit për periudhën 2023-2026 sepse të gjitha institucionet obligohen të zhvillojnë dhe miratojnë planin e integritetit, dhe është obligim ligjor i kësaj agjencie të bëjë monitorimin e zbatimit të Planit të Integritetit të institucioneve publike, në cilësinë e koordinatorit sot do të ra raportojë për shkallën e zbatimit të planit për vitin 2023

Dhe në pika të shkurtra po ju njoftojmë lidhur me kronologjinë e ngjarjeve që kemi kaluar deri tek raporti i zbatimit të këtij plani, me vendim të kryetarit të komunës, janë themeluar edhe grupet punuese për zhvillim të planit të integritetit, për monitorimin dhe raportimin e zbatimit të tij.

Ju njoftoj se në Komunën e Drenasit janë mbajtur dy takime me anëtarët e grupit punues ku është diskutuar për masat e parapara për zvogëlimin apo eliminimin e rreziqeve në planin e integritetit si dhe plotësimi i tabelave nga zyrtarët komunalë me të dhënat e kërkuara sipas masave të parapara në plan dhe është mbajtur një punëtori, ku ka marrë pjesë edhe një ekspert i kësaj fushe.

Plani i Integritetit përmban gjithsej dhjetë fusha të rrezikut dhe katërdhjetë e nëntë masa të propozuara për zvogëlimin apo eliminimin e rreziqeve.

Zbatimi i masave të propozuara në plan, përveç angazhimit të resurseve humane, në këtë rast zyrtarëve komunalë kërkon edhe mjete financiare, si dhe afatet kohore për realizim të këtyre masave.

Në plan është bërë përshkrimi i rreziqeve, masat e kontrollit, ku kryesisht janë të lidhura me ligjet aktet nënligjore, aktet e brendshme komunale, si dhe njësia apo zyrtarët të cilët janë përgjegjës për zbatimin e masave të parapara. Fushat e rrezikut janë klasifikuar në dy grupe: fushat e përgjithshme të rrezikut dhe fushat e veçanta.

Deri më tani, sipas raportimeve nga zyrtarë përgjegjës nga drejtoritë, të cilët janë pjesë në grupe punuese, një numër i veprimeve ndaj rreziqeve të cilat janë parapara në masat e propozuara në plan, janë realizuar, disa janë duke u realizuar dhe disa tjera pritet të realizohen sipas afateve kohore, të cilat janë përcaktuar në planin e integritetit për periudhat në vijim.

Në raportin të cilin e kam hartuar, janë përmbledhur të gjitha të dhënat rreth nivelit të zbatimit të këtij plani për vitin 2023.

Në planin e integritetit për vitin 2023 është planifikuar të zbatohen gjithsej katërdhjetë e nëntë masa me qëllim të parandalimit të dukurive, të cilat ndikojnë në uljen e integritetit të komunës, prej katërdhjetë e nëntë masave të parapara janë realizuar tridhjetë e tre prej tyre apo 67 %. Pesëmbëdhjetë prej tyre janë proces të realizimit, apo 31%, ndërsa vetëm një masë nuk ka filluar të realizohet, apo kthyer në përqindje bie të jetë dy për qind e totalit përgjithshëm të masave. Te fushat e veçanta, Komuna e Drenasit ka parapara gjithsej njëzet e pesë masa për vitin 2023.

Prej tyre janë realizuar nëntëmbëdhjetë apo 76%, kanë filluar të realizohen gjashtë apo në përqindjen 24% dhe nuk ka asnjë masë që nuk ka filluar të realizohet. Te fushat e përgjithshme komuna ka paraparë gjithsej njëzet e katër masa për vitin 2023. Prej tyre janë përfunduar katërmëdhjetë apo 58%, kanë filluar të realizohen nëntë ose 38% dhe vetëm një masë nuk ka filluar të realizohet.

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal përmes një shkrese të datës 15.11.2023 dërguar kryetarëve të komunave të Republikës së Kosovës në përputhje me Ligjin 03/L -040 për vetëqeverisje lokale, i njofton në lidhje me qëllimin e zbatimit të dispozitave ligjore të nenit 25 të ligjit 08/L-017 për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, ku kërkon nga autoritetet komunale hartimin dhe aprovimin e Planit të Integritetit jo më vonë se gjashtë muaj nga aprovimi i metodologjisë për hartimin e këtyre planeve.

Duke pasur parasysh se me datë 26.07.2023, është miratuar Metodologjia për planet e Integritetit nga Agjencia për parandalimin e korrupsionit kërkojnë nga kryetarët e komunave të Kosovës që t'i miratojnë planet e integritetit dhe t'i përcjellin në këtë Agjenci për në Agjencinë për parandalimin e korrupsionit deri në fund të vitit 2023. Planet të cilat janë hartuar nga komunat para aprovimit të kësaj metodologjie të njëjtat duhet të përditësohen dhe të jenë në përputhje me metodologjinë e lartpërmendur, të aprovohen dhe të dërgohen në Agjencinë për parandalim të korrupsionit dhe në këtë rast vlen edhe për Komunën tonë, sepse ne e kemi miratuar planin para miratimit të metodologjisë së lartpërmendur dhe kemi qenë të obliguar të raportojmë në Kuvend për periudhën njëvjeçare të zbatimit të këtij plani, sipas kësaj metodologjie aprovimi i planeve të integritetit bëhet nga kryetarët e komunave tash e tutje.

Egzona Tërdevci: së pari e kam një sygjërim që është teknik, po na kish lehtësu neve me e pa raportin, raporti nuk ka numër të faqeve askund dhe është pak vështirë tani me u referua kur përmendim diçka, ndoshta hera tjera integroni.

Tek integrimi tek pjesa e rreziqeve është diçka shqetësuese mos implementimi i rekomandimeve nga ana e menaxhmentit, nëse mundet me na sqaru, ose zyrtari, ose kushdo që e njeh veten kompetent për këtë çështje? Tek integrimi, rreziqet është me e theksua në rrezik të lartë mos implementimi i rekomandimeve nga ana e menaxhmentit.

A bëhet fjalë për rekomandimet e auditimit të brendshëm, a bëhet fjalë për rekomandimet e ZKA-së, nëse mundet me na dhënë sqarime?

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci: Raporti ka dalë me 98% ne i kemi zbatua rekomandimet e planit tonë, unë nuk kam koment me fol për 2 %.

Meqë nuk pati diskutime vërejtje apo sugjerime tjera kryesuesi hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës: prezent gjatë votimit ishin 29 anëtar, “Për” votuan 22 anëtar, kundër nuk pati, 3 vota abstenim, disa nuk votuan.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal, Milaim Hajdari- hapi diskutimin për pikën e tretë të rendit të ditës: **3. Raport për përfundimin e procesit të zgjedhjes së Këshillave Lokale në Komunën e Drenasit.**

Egzona Tërdevci: meqë kemi pas një bashkëpunim relativisht të mirë nuk kish bë keq nëse na kish konsultu edhe neve kur e ka hartua këtë raport, po e ka ba vetë në rregull është. Unë i kam përcjellë disa vërejte me shkrim, po dua me lexu komplet letrën qysh ua kam dërgu juve që le të mbesim për procesverbal. I pati dy vërejtje lidhur me raportin e

Komisionit për Zgjedhjen e Këshillave Lokale në Drenas me të cilat vërejtje ju lutem që ta përditësoni raportin dhe të na dërgoni të përditësuar para seancës të së mërkurës. Vërejtja e parë është tek faja e dytë e raportit, ku thuhet se përveç në Drenas I, Drenas II dhe Abri, këshilltarët janë zgjedhur me herën e tretë. Gradicë dhe Likoshan janë zgjedhur me herën e dytë, të gjitha të tjerat janë zgjedhur me herën e parë.

Më lejoni të rikujtoj, se as Këshilli në fshatin Baicë nuk është zgjedhur me herën e parë.

Vërejtja tjetër është tek faja tretë e raportit, përkatësisht mungesat e mia si anëtare.

Unë jam e vetëdijshme që nuk kam mundur të jem në secilën mbledhje të Komisionit por megjithatë mungesat e mia nuk janë ashtu siç janë paraqitur në raport dhe për të njëjtat ju lutem t'i përmirësoni.

Nuk janë nënshkruar qëllimshëm në dy mbledhje. Llapushnik nuk janë pajtuar se si është menaxhuar zgjedhja e Këshillit apo përfaqësuesit e lagjeve dhe e kam informua kryesuesin e Komisionit për arsyen e mos nënshkrimit.

Në Arllat kam pasur një telefonatë urgjente nga familja dhe brenda rreth katër minutave, sa kam zgjatë në telefon, procesi ka përfundua pa qenë unë prezentë dhe është krejtësisht e natyrshme që të mos nënshkruhem në një situatë të tillë kur koha që unë kam qenë jashtë nuk ka qenë koha e gjatë për të me pritur. Kërkoj që këto çështje të përditësohen në raport.

Për me gjerësisht mbledhjen e Kuvendit Komunal Drenas e gjeni në you tube dhe materialin e gjeni në ueb faqen zyrtare të Komunës. <https://www.youtube.com/watch?v=Cw7vnmkr6AA>

<https://kk.rks-gov.net/glllogoc/wp-content/uploads/sites/10/2023/11/Ftesa-dhe-materiali-i-mbledhjes-se-Kuvednit-Komunal.pdf>

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci: Besoj që je aq e vetëdijshme, çka është procesverbale e çka transkripta, dhe fjala jote ose imella që e ke dërguar tek ne nuk hyn në procesverbal, e ke lexu ka mbetë e regjistruar, dhe e ke të publikuar. Mungesat tua janë të vërteta dhe nuk ta ka bërë dikush asnjë gjë të pavërtetë, ka anëtarë të komisionit këtu, ndërsa tema tjera ke dalë katër minuta, a dy dy minuta jashtë askujt s'i intereson, komisionet janë mbajtur, njerëzit janë zgjedhur ata që i kanë votu ata që kanë marrë pjesë, kështu që rregull jem.

Egzona Tërdevci: Po e kam qartë që nuk del komplet pjesa jem, po vetëm mundet në procesverbal me u cekë që unë si asambleiste dhe si anëtare e komisionit kam pas vërejtje. Edhe mungesat e mia nuk janë reale.

E keni aty pasqyrimin që unë i kam pesëmbëdhjetë mungesa, realisht kam mungu vetëm në njëmbëdhjetë, kërkoj ta përmirësoni.

Beqir Kiqina: Sa i përket raportit për përfundimin e procesit të zgjedhjes së këshillave lokale në Komunën e Drenasit, më lejoni të them se unë si anëtar i Komisionit ndihem shumë mirë, për arsye se kemi arritur të kurorëzojmë një punë relativisht të gjatë disa mujore dhe në fund do të thotë të këtij procesi të përfundojë pa asnjë eksces të mundshëm në të gjitha lagjet urbane dhe në gjitha bashkësitë lokale të Komunës së Drenasit

Sa i përket çështjeve të mungesave pajtohem relativisht me kolegën parafolëse, nuk besoj që ka pas momentin kur është kuorumi, nuk e di pse duhet mi mi paraqitë mungesat, por sido që të jetë, në çdo mbledhje ka pasur kuorum. Ndërsa sa i përket çështjes tjetër, se në Llapushnik dhe në Orllat ka pasur sipas saj ose shkelje të rregullore ose diçka këtu e them me plot kompetencë dhe me plot përgjegjësi këtu para Kuvendit Komunal. Llapushnik është prej proceseve më të mira në Komunën e Drenasit, që ka pas njerëz qytetarë dhe qytetare të mjaftueshëm, domethënë është respektu dhe kuota gjinore, sepse është organizu ky fshat

mjaft mirë dhe gjitha ato i kemi edhe procesverbalet, edhe me veti domethënë mbledhjes përkatëse. Po ashtu gjithçka ka shku në rregull, por është e drejtë e koleges mund e nënshkrua apo jo. Ndërsa sa i përket për fshatin tjetër në Arllat e përmende është e vërtetë që ke dalë jashtë, por është më se e vërtetë që nuk na ka tregu a duhet me të pritë, a e ke për urgjent apo vetëm e ke një telefonatë blic, do të thotë dhe do të rikthehesh përsëri. Kështu që edhe aty ka shku mbledhja mjaft mirë dhe nuk e di ndonjë vend ku koha që ia vlen të ceket që ka pas shkeljeve të rregullore.

Egzona Tërdevci: nuk thashë që në asnjë prej fshatrave u shkel Rregullorja, për Llapushnik thashë se nuk jam pajtu si është menaxhu zgjedhja e anëtarëve të këshillit lokal edhe ka qenë e drejtë e jemja të mos nënshkruhem.

E për Arllat, une e kam njoftu kryesuesin që po dal për një telefonatë shpejt, po ai e ka pasur të arsyeshme mos me më pritë edhe ka kalu kjo çështje.

Beqir Kiqina: Në Arllat ka pas kuorum. Ne nuk e kemi ditë që është largu kolegia dhe falënderojmë për kontributin secilin, mirëpo në momentin kur është largu, janë dy forma të votimit, një është me akumulacion me ngritje duarsh, edhe tjetra është me votim të fshehtë. Me votim fshehtë e kemi përcjellë procesin për numërim të votave dhe ka zgjatë më shumë, ndërsa pjesën tjetër, ajo është punë më shpejtë, me ngritje duar, kur të gjithë janë të pranishëm domethënë, për një kandidat të caktum, atëherë vetë procesin na nuk mujna me zgjat më shumë sesa është i paraparë.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal, Milaim Hajdari: Sa i përket përgjigjes që ka kërkuar Egzona, ne jemi kanë në njohuri, ajo është drejtuar edhe te unë të nënkryetarin në këtë rast, po realisht

Është mirë si rregull, kur janë pjesë asambleje është mirë paraprakisht duhet me diskutu komisioni, që kur bahet një raport s'mund komisioni mes veti mos me pas mos paqartësi. Është e parëndësishme do të thotë pjesëmarrja ose mospjesëmarrja individuale, si Komision ka ba një punë të shkëlqyeshme, e vlerësoj.

Meqë nuk pati diskutime tjera kryesuesi hodhi në votim formalisht këtë pikë të rendit të ditës: prezent gjatë votimit ishin 29 anëtar, “Për” votuan 25 anëtar, kundër nuk pati, abstenim nuk pati, 4 nuk votuan.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal, Milaim Hajdari- hapi diskutimin për pikën e katërt të rendit të ditës: **4. Propozim vendim për mbështetje financiare e Qendrës për Promovimin e të Drejtave të Grave.**

Albulena Saliuku: si për çdo propozim tjetër që është kërkuar mbështetje financiare që e kemi përkrahur dhe e kemi votuar edhe sot pika katër kërkon mbështetje për Qendrën për Promovimin e të Drejtave të Grave, drejtoresha e kësaj qendre, zonja Kadire Tahiraj, e ka bërë dhe po vazhdon të bëjë një punë të jashtëzakonshme për mbrojtjen dhe promovimin e grave në Komunën tonë, por edhe jashtë saj.

Angazhimi për fuqizimin e gruas në shoqërinë tonë e kemi me obligim secili prej ne dhe kjo qendër po bën shumë për fuqizimin e gruas, si dhe përmirësimin e nevojave të grave.

Prandaj, sot dhe gjithmonë do ta kenë mbështetjen time dhe duhet të jemi unikë të gjithë në vendime të cilat janë në interes të përgjithshëm të qytetarëve tonë.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal, Milaim Hajdari- hapi diskutimin për pikën e pestë të rendit të ditës: **5. Propozim për ndryshim-plotësimin e rregullores për taksa tarifa, ngarkesa dhe gjoba Nr.030/01-53502 të datës 27.10.2023.**

Egzona Tërdevci: Po e përsëris, atë që e thashë tek rendi i ditës që këto materiale është dashur t'i kemi më herët. Nëse nuk ka qenë e nënshkruar raporti, shkresat nga ministritë përkatëse që e kanë trajtuar ligjshmërinë e kësaj Rregullore kanë qenë dhe keni mund t'i përcjellni. Gjithashtu, dua të evidentoi një vërejtje për seancën e kaluar, ku ne si grup i asamblesëve kemi bërë propozime për këtë Rregullore dhe ju nuk i keni hedh në votim propozimet tona. Ne ndoshta nuk do ta kishim kalu propozime me votë, meqë nuk e kemi shumicën, po parimisht si rregull është dashtë të vendosni në votim.

Edhe një vërejtje që po përsëritet në vazhdimësi sipas Ligjit për vetëqeverisje lokale, paragrafit 46 përkatësisht pika 2 kuorumi duhet të verifikohet para secilit votim.

Ne jemi tu e kalu këtë hap, nuk është shumë problem ndoshta që me e realizu këtë rregull që kërkon ligji për vetëqeverisje lokale.

Meqë nuk pati diskutime vërejtje apo sugjerimeve kryesuesi hodhi në votim formalisht këtë pikë të rendit të ditës: prezent gjatë votimit ishin 29 anëtar, "Për" votuan 23 anëtar, 4vota kundër, 2 vota abstenim.

Mungesë kryesuesit mbledhjen e udhëhoqi asamblisti Gani Krasniqi:

Gani Krasniqi hapi diskutimin për pikën e gjashtë të rendit të ditës: **6. Propozim vendim për formimin e Panelit Përzgjedhës për zhvillimin e procedurave për themelimin e Komitetit Konsultativ Komunal për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport.**

Vazhdojmë me propozimet:

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci: Propozoj formimin e Panelit Përzgjedhës nga Ekzekutivi Agim Kastrati, nga shoqëria civile: Bekim Binaku.

Bekim Lestrani propozoj:propozu prej prej grupit të PDK-së e propozojmë Valentina Leku Gashi.

Azemine Bujupi: Nga Grupi i DD-së e propozoj Marigona Bazaj.

Egzona Tërdevci: Nga Grupi i Asamblesëve të Lëvizjes Vetëvendosje, për panel përzgjedhës të Komitetit propozojmë Drin Halilaj.

Meqë nuk pati diskutime vërejtje apo sugjerimeve kryesuesi hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës: prezent gjatë votimit ishin 30 anëtar, "Për" votuan 30 anëtar, kundër nuk pati, abstenim nuk pati, u formua Panelit Përzgjedhës për zhvillimin e procedurave për themelimin e Komitetit Konsultativ Komunal për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport me:

Agim Kastrati (anëtar nga Ekzekutivi)

Bekim Binaku (anëtar nga shoqëria civile)

Valentina Leku Gashi (anëtare nga Kuvendi)

Marigona Bazaj (anëtare nga Kuvendi)

Drin Halilaj (anëtare nga Kuvendi)

Gani Krasniqi hapi diskutimin për pikën e shtatë të rendit të ditës: **7. Propozim vendim për formimin e Panelit Përzgjedhës për zhvillimin e procedurave për themelimin e Komitetit Konsultativ Komunal për Persona me Aftësi të Kufizuara.**

Vazhdojmë me propozimet:

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci: Propozoj formimin e Panelit Përzgjedhës nga Ekzekutivi: Zahrie Podrimqaku-Subashi nga shoqëria civile: Shqipe Hoxha.

Bekim Lestrani: Nga PDK-ja nga grupi i PDK-së propozojmë Malësore Cakiqi.

Azemine Bujupi: Nga grupi i DED-së. Nga grupi i DD-së propozojmë Mehedin Salihu.

Egzona Tërdevci: Nga Grupi i Asamblesë së Lëvizjes Vetëvendosje, për këtë panel konsultativ e propozojmë asamblesten Filloreta Bujupi.

Meqë nuk pati diskutime vërejtje apo sugjerimeve kryesuesi hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës: prezent gjatë votimit ishin 30 anëtar, “Për” votuan 30 anëtar, kundër nuk pati, abstenim nuk pati, u formua **Panelit Përzgjedhës për zhvillimin e procedurave për themelimin e Komitetit Konsultativ Komunal për Persona me Aftësi të Kufizuara nga:**

Zahrie Podrimqaku-Subashi (anëtare nga Ekzekutivi)

Shqipe Hoxha (anëtare nga shoqëria civile)

Malësore Cakiqi (anëtare nga Kuvendi)

Mehedin Salihu (anëtare nga Kuvendi)

Filloreta Bujupi (anëtare nga Kuvendi)

Gani Krasniqi: hapi diskutimin për pikën e tetë të rendit të ditës: **8. Propozim vendim për formimin e Panelit Përzgjedhës për zhvillimin e procedurave për themelimin e Komitetit Konsultativ Komunal për Zhvillim Ekonomik, Mbrojtje të Ambientit, Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale.**

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci: Propozoj formimin e Panelit Përzgjedhës nga Ekzekutivi Gentianë Morina, nga shoqëria civile: Burim Dvorani.

Bekim Lestrani: Nga PDK-ja nga grupi i PDK-së propozojmë Albulena Saliuku.

Azemine Bujupi: Nga grupi i DD-së propozojmë Hamit Haxhiu.

Egzona Tërdevci: Nga Grupi i Asamblesë së Lëvizjes Vetëvendosje, për këtë panel konsultativ e propozojmë asamblistën Florentina Elezi Veliu.

Meqë nuk pati diskutime vërejtje apo sugjerimeve kryesuesi hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës: prezent gjatë votimit ishin 30 anëtar, “Për” votuan 30 anëtar, kundër nuk pati, abstenim nuk pati, u formua **Paneli Përzgjedhës për zhvillimin e procedurave për themelimin e Komitetit Konsultativ Komunal për Zhvillim Ekonomik, Mbrojtje të Ambientit, Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale nga:**

Gentianë Morina (anëtare nga Ekzekutivi)

Burim Dvorani (anëtare nga shoqëria civile)

Albulena Saliuku (anëtare nga Kuvendi)

Hamit Haxhiu (anëtare nga Kuvendi)

Florentina Elezi Veliu (anëtare nga Kuvendi)

Gani Krasniqi: hapi diskutimin për pikën e nëntë të rendit të ditës: **9. Propozim vendim për plotësim ndryshim të vendimit të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi.**

Laureta Thaqi Drejtoreshë e Administratës: Pra, përmes këtij propozim-vendimi ë po kërkojmë mu ndryshu apo plotësu vendimi i Këshillit Komunal për Sigurinë në bashkësi meqenëse disa nga anëtarët e KKKS-së kanë ndryshuar pozitat zyrtare, njëri nga komunitetet si FSK kam propozuar anëtarë të ri dhe anëtar i Komitetit të Biznesit, i cili zëvendësohet sipas nenit pesëmbëdhjetë të udhëzimit të MPB-së, atëherë po propozojmë miratim plotësim-ndryshimin e këtij vendimi. Pra, janë emra të cilat do të zëvendësohen sipas udhëzimit. Jam konsultuar Në pozitën koordinatorë e KKKS-së jam konsultuar me Divizionin për Sigurinë në bashkësinë kuadër të MPB-së dhe kanë kërku që të gjithë emrat pra që janë zëvendësu, që kanë ndryshu pozita zyrtare me kalu përmes Kuvendit, për arsye se edhe atëherë kur janë emëruar kanë kalu përmes Kuvendit Komunal. Pra, vetëm është një plotësim-ndryshim i i këtyre pozitave të cilat i keni të specifiku me nenin ë një të këtij propozim-vendimi.

Meqë nuk pati diskutime vërejtje apo sugjerimeve kryesuesi hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës: prezent gjatë votimit ishin 30 anëtar, **“Për”** votuan 30 anëtar, kundër nuk pati, abstenim nuk pati.

Gani Krasniqi hapi diskutimin për pikën e dhjetë të rendit të ditës: **10. Propozim vendim për plotësim ndryshimin e nenit 2 të vendimit nr.02-463/05-53498 për dhënien në shfrytëzim afatgjatë për 99 vite, Pronën e Paluajtshme të Komunës me procedurë të negocimit të ofertës.**

Meqë nuk pati diskutime vërejtje apo sugjerimeve kryesuesi hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës: prezent gjatë votimit ishin 29 anëtar, **“Për”** votuan 25 anëtar, 4 vota kundër 1 abstenim.

Gani Krasniqi hapi diskutimin për pikën e njëmbëdhjetë të rendit të ditës: **11. Të ndryshme.**

Labinot Halilaj: pyeti lidhur me ndërprerjen e kontratës e Kosova-Med për shërbimet shtëpiake shëndetësore në shtëpi. Cila ka qenë arsyeja pse u ndërpre kjo kontratë, nëse ka mundësi me na dhe dikush përgjigje, pse është pezullu kontrata?

Lumnije Krapa Drejtoreshë e Shërbimeve Publike: vetëm po e sqaroj se nuk kemi ndërprerje të kontratës, po pezullim, pezullim të shërbimeve deri në një vendim tjetër që duhet të respektohet vendimin e Inspektoratit. Domethënë s'kemi ndërprerje, po pezullim deri te një vendim tjetër i ardhshëm. Arsyen ata nuk e dinë.

Laureta Thaqi Drejtoreshë e Administratës: Meqë kjo kontratë është e lidhur prej Zyrës së Prokurimit, zyra e cila funksionon në kuadër të Drejtorisë për Administratë atëherë, kjo kontratë nuk është ndërprerë, por është pezullu për shkak se kemi një një raport apo një rekomandim të Inspektoratit Shëndetësor për pezullim të shërbimeve lidhur me këtë kontratë. Sa i përket aspektit ligjor nënshkruar nga Zyra e Prokurimit, pra kjo kontratë është nënshkruar në përputhje me Ligjin për Prokurimin Publik, po ashtu në përputhje me rregulloret dhe udhëzuesit të cilët i rregullojnë çështjen e projekteve përmes prokurimit publik, pra nuk ka pasur asnjë problem, mirëpo është pezullu përkohësisht deri në një vendim tjetër të Inspektoratit. Inspektorati Shëndetësor është organ mbikëqyrës më i lartë lidhur me ofrimin e shërbimeve shëndetësore. Është pezullu, por po presim pra një vendim, por nuk

është ndërprerë, për shkak se kjo kontratë është e lidhur mes Zyrës së Prokurimit dhe Operatorit Ekonomik në fjalë, pra Kosova Med.

Labinot Halilaj: Pra, e njëjta pyetje: Pse Inspektorati e ka rekomandu për pezullim?

Krytari i Komunës Ramiz Lladrovci: Inspektorati na ka dhënë rekomandim në rekomandim, pra me pezullu. Në c kemi pezullu landën, landa është në proces, nuk ka me neve kush do të bëjë na këna blejë shërbime dhe na jemi në rregull me shërbime, i ka kalu të gjitha procedurat, KRPP-ja e vlerëson a jemi në rregull me procedurat, OSHP-ja është gjithashtu një gjykatë që vendos kush me e marrë, na nuk kemi asnjë problem, janë probleme me kompanisë edhe Inspektoratit Shëndetësor. Në i kemi kry 70% të shërbimeve edhe ashtu kur i kryen shtatëdhjetë për qind të kontratës, kontrata quhet e përfundime edhe ashtu shty nuk ka pasë asnjë vërejtje nga as nga pacientë dhe as nga askush tjetër deri sot janë procedura që do të zhvillohen. Na nuk shkelim ligj kur thotë Inspektorati rekomandon me pezullu. Na ka rekomandu, na i kemi, ju kemi shkru me na këtij përgjigje, presim përgjigje, edhe ashtu kontrata është mbi shtatëdhjetë për qind kur kryhet kontrata kornizë

Hamit Haxhiu: Qysh u lidh kjo kontratë dhe ky operator a ka certifikatë e biznesit? Pasi është vetëm rekomandim për shpëputje të kontratës diçka nuk është në rregull.

Krytari i Komunës Ramiz Lladrovci: Gjithë zyrtarët që kryejnë shërbim janë të certifikuar. Në komunë që kryejnë shërbim nuk ka drejtorit tyre certifikatë për shërbim, ai është kompani e cila na ka ofru shërbim, ke na kry shërbim, na jemi në rregull, me ligjin dhe me gjithçka Telashet me kompanisë edhe inspektor, janë procedura që zhvillohen. Tutje domethanë, nga tri vjet po i bën kjo kontratë që nuk ka pas asnjë vërejtje as bij inspektorati dhe as prej askujt. Në pra, këna ble shërbime shërbimet tona janë kanë profesionale dhe i kanë plotësu të gjitha kriteret. Edhe na damtojnë këtë proces për për dhënien e shërbimeve të qytetarëve në shtëpi, po është çështje që na nuk bëjmë gabime nëse na ka japë dikush një rekomandim. Mundet që nesër kompania me na me na çu në gjykatë, në qoftë se nuk ka pas drejtë Inspektori i Shëndetësisë edhe na me ia pagu atij shërbimi, të bëjë kry shërbimet. Faleminderit! Po na e mbajmë përzgjedhës Ministrinë e Shëndetësisë, sepse i kemi thënë qoftë se gjykata vendos kundër tënd, do të mbani përgjegjësi ju.

Mehedin Salihu: ndërlidhen në këtë pikë kjo kompani kryetare operon edhe në komunat tjera të Kosovës pse një gjë e tillë nuk ka ndodh në komunat tjera, po veç tonën, a është pezullu puna veç për punëtorë shëndetësorë a për punëtorë tjerë?

Krytari i Komunës Ramiz Lladrovci: nuk e kanë pezullu veç në Komunën tonë, është edhe në Komunën e Klinës, problemet na nuk i shqyrton problemet me kompanisë dhe Inspektoratit, se është tema jonë. I vetmi gjë që neve na atakon, është se na në punë jam i dhënë përkohësisht shërbime qytetarëve. Na kena në atë kompani dy kontrata dhe kontrata me numër XY na ka rekomandu me suspendu, me na ka rekomandu. Ata e kena suspendu. Kompaninë tjetër, ose kontratën tjetër me të njëjtën kompani, nuk na ka rekomandu me na rekomandu, veprojmë sipas rekomandimeve e që na vijnë nga niveli qendror

Egzona Tërdevci: Edhe unë i kam disa çështje lidhur me rastin e kontratës së Kosova Med Fillimisht, kontrata nuk është e nënshkrume veç me Kosova med edhe Zyrës së Prokurimit, kontratën e kam këtu dhe ju zotëri Lladrovci jeni nënshkruesi i kontratës që nuk kam nejsan me këtë çështje, po veç me kanë në ferr që nuk është çështja veç te zyra e prokurimit a e ka ditë komuna në fillim që ky operator nuk ka licencë për ofrimet e shërbimeve shëndetësore?

Nëse e ka ditë, qysh ka leju me u nënshkru një kontratë e tillë e nëse nuk e ka ditë kur është sinjalizu që kjo kompani nuk ka licencë për ofrim shërbimeve shëndetësore. Pasi unë i kam disa shqetësime që me ia përcjellë se ë shërbimet që kinse janë realizuar nga kjo ë kompani, në fakt nuk janë realizu. Pra, ka pacient, ka lista fiktive të pacientëve dhe nuk janë realizu të gjitha shërbimet. Po ashtu, ka dyshime se janë disa njerëz që ë thuhet se janë të afërt me pushtetin komunal dhe njerëz të caktuar në QKMF që marrin paga pa kryer shërbime për këtë kompani dhe madje disa paga janë edhe të majme, një nëse është e vërtetë, unë po pyes për sqarime, thuhet se paguan njerëzit pesë mijë e dyqind euro nga nga kjo kontratë, a e keni thirrë në përgjegjësi menaxherin e kontratës, pra drejtuesin e QKMF-së për këtë çështje A jeni kanë sinjalizu më herët për problemet që i ka kjo kompani dhe cilat janë veprimet që tash e tutje keni me marrë si komunë për këtë çështje? Konsideroj që nuk është shumë e vogël shuma prej treqind e shtatëdhjetë e dy mijë e gjashtëqind euro për Komunën e Drenasit që ka një buxhet të vogël dhe një kontratë e tillë nuk do të dohej të kalohej kaq pa u vërejtur nëse nuk është implementu siç duhet.

Krytari i Komunës Ramiz Lladrovci: Egzonë, kontratat për shërbime që janë me vlerë mbi njëqind e njëzet e pesë mijë euro, njëqind e njëzet mijë sa është, i nënshkruaj unë krejt asnjë shqetësim s'e kam për atë punë, sepse janë në rregull procedurat shërbimet që i kemi kërku na kanë kalu përmes KRPP-së, një institucion që thotë duhet me pasë edhe qit certifikatë, duhet me pasë edhe qit dokument, duhet me pasë edhe qit dokument. për dijeni tonën, i kena kalu krejt. Ndërsa, njerëzit a janë të afërt me kryetarin apo ekzekutivin apo në komunën që punojnë aty ose që marrin pagat majme, që unë nuk i di. Na kena blerë shërbime. Na nuk kena, na nuk dojmë paga. nuk i dhonë paga kërkujt. Ç'më thanë edhe je gëzohen, tash kur thu kështu i afërt i dhe baba ai të më voton mua, po ç'a me i votash? Ti duhet me të bajtë kaq herë përtej asaj që baba ai të më e voton PDK-në, nuk më voton e Kështu që janë tema që nuk i nuk i nuk na shqetësojnë neve, sepse janë janë organe të cilat ë çka të keni, i çoni atje, na iu dhonë përgjigje çdonjërit qysh i kemi dhënë deri sot. Licencat janë domethanë gjithë punonjës që i ka shërbimet që na jep neve, kanë licenca. Për çfarëdo që kërkohet në ato shërbime.

Egzona Tërdevci: një pyetje për drejtoreshën Lumnie Krapit. Shërbimet që ka pasë m'i kry kjo kompania, a është e vërtetë që tash janë tu u kry prej shërbyesve të emergjencës edhe kështu emergjenca po mbetet keq për staf?

Hamit Haxhiu: Pyetja ime ishte kështu për Drejtorinë e Infrastrukturës ose Drejtorinë e Arsimit: Drejtorina e Arsimit po përcjell një problem i zakonshëm që disa vite për nxëniet qendrore, i nderuar drejtor. pse shumë shkolla nuk janë gatshme me nxehjet qendrore. Për Drejtorinë e Infrastrukturës, çka po ndodh me kockat e sheshit "Fehmi dhe Gjevë Lladrovci" Ku po shkojnë, ku janë ato kocka, çfarë po ndodh me ato kocka të sheshit?

Muhamet Gjoka Drejtor i Arsimit: Lidhur me shqetësimin e ngritur, ju njoftoj që të gjitha shkollat janë të pajisura me lëndë djegëse, sigurisht për një kohë të caktuar, po nga këto i sigurojmë gjithë nxënësit prindërit, mësimmshënësit, edhe juve që nuk do të mbeten asnjë asnjë moment pa lëndë djegëse. Sigurisht se sistemi i ngrohjes mundet me pas ndonjë telashe teknike, por edhe për ato e kemi e kemi një kontratë, e cila veç është në procedurë është përfunduar. sigurisht edhe aty reagimi do të jetë me kohë. Kështu që ne procedurën e kemi nisë qysh në fillim të gushtit, mirëpo dy herë ka shku radhazi në në OSHP falë menaxhimit të mirë të sasive të lëndëve djegëse kemi rezerva nga viti i kaluar kështu që ë i siguroj edhe një herë

të gjithë prindërit nxënësit mësimdhënës që asnjë moment, asnjë ditë nuk do të mbesin pa pa lëndë djegëse.

Krytari i Komunës Ramiz Lladrovci: për kocka, unë nuk e di ku janë tu shku ato kocka, Na e këna lut operatorin që na i dhunë në shërbim ato kocka, sepse operatori kur e merr punën gjithçka që ka aty e merr shërbim të vetin edhe e çon ku i intereson, po jam i bindur si ai ka me na respektu kërkesën tonë edhe kockat kanë me metë një vend, kanë me u deponu një vend dhe na e kemi mendu me i dërgu për parkingjet shkollave e të institucioneve tjera.

Lumnije Krapë Drejtoreshë e shëndetësisë: e nderuar Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale në koordinim me Qendrën e Mjekësisë Familjare në Drenas, në mënyrë që qytetarët e Komunës së Drenasit dhe mos mbosin pa shërbim dori në një vendim të ardhshëm, është mobilizuar dhe shërbimet e kujdesit paliativ në shtëpi janë duke u realizuar nga ekipet mjekësore të QKMF-së orari është nga ora tetë deri në orën pesëmbëdhjetë, në numrat 038-584-049, ndërsa në raste emergjente, pas orës tre thirret urgjenca, kush ka nevojë

Egzona Tërdevci: Drejtoreshë, unë pyeta që ai ekip mjekësor që po del në terren, a është ekipi i emergjencës që në këtë situatë a mbetet keq emergjenta për atë ekip, nëse është ekip tjetër, të lutna veq ndaje me neve!

Krytari i Komunës Ramiz Lladrovci: emergjenca punon njëzet e katër orë, punon edhe ditën kur janë gjithë mjekë tjerë në punë. Edhe me shku emergjenca ka mjekë, nuk jetë institucioni pa mjekë, dua ta bëj një sqarim edhe për qytetarë do me hanë ka kur s'ka, kur është orari ndërrimi i tretë, atëherë e kena ma problem po dhe atëherë shkojnë kur është emergjencë, aksident a diçka edhe jetë emergjenca pa mjek.

Florentina Elez-Veliu: unë i kam dy pyetje për drejtorin e Arsimit e para është: a janë të furnizu në tashmë shkollën Komoran edhe në Baicë me lëndë djegëse dhe pyetja e dytë është për shkollën “Rasim Këqina” pasi siç e dimë që tri javën, nëse nuk janë gabim, është zhvillu mësimi me tri ndërrime, apo me ditë pse ka ndodhë, a është keqmenaxhim, që ka ndodhë kjo, që tualetet nuk janë renovu në kohën e pushimit, kur e kanë pas nxënësit në ngushtë po tani me hupë nxënëse atë mësimin, siç dihet janë disa orë që mban vetëm kah dhjetë minuta dhe nuk e di a është gati ajo me përfundu dhe pse ka ndodhë që tashmë u renovu ajo, e jo gjatë pushimit.

Krytari i Komunës Ramiz Lladrovci: shkolla e Baicës është ndërtu është kry shërbimet e efijencës pra, janë ndërru kaldaja edhe e kanë bo me peletë, ne kena dru të mjaftueshme atje, po s'kena pas peletë, a u desht me marrë dikun peletin. Për mësim nuk o e vërtetë se i marrin dhjetë minuta orët e mësimin. E dyta Kjo është tema e druve, është prej gushtit, ne kemi zhvillu procedura të ngushtë, dy kompani janë që e furnizojnë krejt Kosovën me dru dhe me bilet, edhe na mbesim kështu.

Muhamet Gjoka Drejtor i Arsimit: e nderuar, lidhur me shqetësimin e juaj, ju njoftoj që ë në shkollën e “Rasim Këqina” është duke u punu në një pjesë, në një pjesë të tualeteve dhe si pasoje e kësaj është dashtë me e menaxhu sigurisht me i shkurtu, po jo me dhjetë minuta, tridhjetë e pesë minuta, jo, unë e kam edhe orarin mu me me nda me juve, sigurisht që e dëshmon praktikisht nëse ka ndodhë ndonjëherë e dhe një informatë shitesë, një informatë shitesë pse procedurat janë zhvillu tash? ju njoftoj që projektin për renovim të objekteve shkollore e kemi pas për herë dyvjeçar nga viti i kalum dhe sigurisht kontrata u ne shkru në vitin e kalum dhe janë kry të gjitha punët që kanë qenë të paraparë me kontratë. Mirëpo, për

shkak të nevojave të shkollave, me aprovimin e juaj në buxhet në këtë seancë të Kuvendit kemi siguru buxhet shtesë edhe njëqind mijë euro, dhe është dashtë të pritët që të përfundohet kontrata e parë, në mënyrë që të vazhdojmë me procedurën. Kjo është arsyeja pse pak më vonë janë zhvillu procedurat, po gjithmonë në interes të nxënësve që të bahet më e mira dhe t'ju krijohet një infrastrukturë e përshtatshme.

Mehedin Salihu: dashta me ditë konkretisht, a ka ndonjë shkollë që nuk ka nxemje?

Muhamet Gjoka Drejtor i Arsimit: jo, nuk ka asnjë shkollë që nuk ka lëndë djegëse. Në shkollën e Tërstenikut është duke u punu në sistemin e ngrohjes. Besoj që deri nesër përfundohet sistemi komplet dhe nuk ka asnjë shkollë që nuk ka ngrohje.

Krytari i Komunës Ramiz Lladrovci: për prind unë i thërras publikisht, është faqja zyrtare e komunës kushdo që ka ankesa, jo veç për ngrohje, po për çfarëdolloj ankese, problemi që ka me shkollat, po edhe çdo gjë tjetër, le ta bënë ankesën në email zyrtar të komunës edhe na i kthejmë përgjigje, përndryshe i konsiderojmë deklaratat si informata të vërteta.


Hamit Haxhiu: më e rëndësishme është me pas nxemje qendrore nëpër shkolla sesa që e ke pritë përgjigjen prej OSHP-së, edhe në këtë rast edhe të sheshi më mirë o kanë hiç mos me pritë organi shqyrtues të prokurimit me i ba gati shkollat me nxemje qendrore dhe në rregull .

Krytari i Komunës Ramiz Lladrovci: edhe unë këtë përgjigje ia bëj OSHP-së, publikisht po e them, është njëfarë vlerësuesi atje, me kthi përgjigje unë veç ditë ia numëroj, kështu që ne po flasim për dy shkolla që u kanë nderrua kaldoja, ka pa një ditë problem që s'ka pas ngrohje, qato e kanë qitë mediat edhe qato u veprime vetëm po i përsëritni ju.

Meqë nuk pati diskutime tjera kryesuesi e konsideroj të mbyllur seancën, seanca përfundoj rreth orës 11:50 min.


Me gjerësisht, mbledhjen e rregullt të Kuvendit të Komunës së Drenasit të datës 22.11.2023 mund të ndiqni në ueb faqen zyrtare të komunës, rrjetin social të Facebook-ut dhe në kanalin YouTube.

Procesmbajtëse:


Liridona Fejza-Ajazi



Kryesuesi i Kuvendit Komunal


Milaim Hajdari



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komuna e Drenasit
Zyra e Kryetarit



Nr 01-070101-60696 dt. 18/12/2023

Në bazë të nenit 58 paragrafi 1 pika (h) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040, nenit 72 të Statutit të Komunës së Drenasit, Kryetari i Komunës së Drenasit, propozon: Në bazë të nenit 11, 12 paragrafi 1, nenit 40, paragrafi 2 pika h, të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, nenit 3, pika 3.5 të Statutit të Komunës së Drenasit, Kuvendi i Komunës së Drenasit në mbledhjen e mbajtur më ____12.2023, të aprovojë këtë:

PROPOZIM VENDIM

Për shpalljen e z. Hashim Thaçi "Qytetar Nderi" i Komunës së Drenasit

Neni 1

Me këtë Propozim Vendim, i propozohet Kuvendit të Komunës shpallja e z. Hashim Thaçi "Qytetar Nderi" i Komunës së Drenasit.

Neni 2

Titulli "Qytetar Nderi" për z. Hashim Thaçin i jepet për kontributin e tij të jashtëzakonshëm për çlirimin, pavarësimin, shtetformimin dhe shtetndërtimin e Republikës së Kosovës.

Neni 3

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës së Drenasit.

Neni 4

Ky vendim hyn në fuqi nga dita e miratimit nga Kuvendi i Komunës dhe vlerësimi të ligjshmërisë nga ana e MAPL-së.

Kryetari i Komunës
Ramiz Lladrovci

ARSYETIM

Hashim Thaçi

Ish President i Republikës së Kosovës - (2016 - 2020)

Hashim Thaçi ishte President i Republikës së Kosovës, i zgjedhur më 26 shkurt 2016 në Kuvendin e Kosovës. Detyrën e presidentit e mori më 7 prill 2016, pas betimit solemn në Kuvendin e Kosovës.

Para se të bëhej president, Thaçi ka qenë një vit Zëvendëskryeministër i Parë dhe Ministër i Punëve të Jashtme (2014-2015), si dhe Kryeministër i Republikës së Kosovës në dy mandate (2007-2014).

Thaçi ka qenë kryetari i parë i Partisë Demokratike të Kosovës dhe është rizgjedhur vazhdimisht kryetar i partisë, deri më dorëheqjen e tij më 26 shkurt 2016, para se të votohej për President të Kosovës.

Hashim Thaçi ka shpallur Kosovën shtet të pavarur më 17 shkurt 2008, ka udhëhequr ekipin e Kosovës në bisedimet në Rambouillet në shkurt 1999 dhe ka qenë udhëheqës politik i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës gjatë viteve të luftës 1997 – 1999.

Thaçi ishte lideri politik më i votuar në zgjedhjet e 8 qershorit 2014.

Si Kryeministër i Kosovës, Hashim Thaçi, ka udhëhequr dialogun politik mes Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë, që më 19 prill 2013, rezultoi me nënshkrimin e marrëveshjes për normalizimin e marrëdhënieve mes Kosovës dhe Serbisë.

Për angazhimin e tij për paqe dhe stabilitet, në vitin 2014, Hashim Thaçi është nominuar për Çmimin Nobel për Paqe nga kongresmenë dhe senatorë amerikan, si dhe nga përfaqësues të Parlamentit Evropian.

Karriera politike

Karriera politike e Hashim Thaçit fillon me angazhimin e tij në Lëvizjen Popullore të Kosovës (LPK), lëvizje politike kjo që synonte emancipimin e pozitës së shqiptarëve në ish-Jugosllavi. Si student në Universitetin e Prishtinës, Thaçi u bë lider i Lëvizjes Studentore në periudhën mes viteve 1990 dhe 1993, vite këto kur pushteti i Beogradit mbylli institucionet arsimore universitare në gjuhën shqipe, ndërsa Universiteti i Prishtinës filloi të vepronte jashtë sistemit institucional.

Më 1991, Thaçi zgjidhet prorektor-student i Universitetit të Prishtinës, ku jep kontribut në strukturimin dhe zhvillimin e procesit paralel mësimor universitar.

Hashim Thaçi është njëri ndër themeluesit e organizatës politiko-ushtarake, Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK).

Nga viti 1997, Hashim Thaçi ishte udhëheqës i Drejtorisë Politike të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Në këtë cilësi, ai kryesoi delegacionin e Kosovës në Konferencën Ndërkombëtare të mbajtur në Rambouillet të Francës, nga 6 deri më 22 shkurt 1999.

Pas luftës, Hashim Thaçi ishte kryeministër i Qeverisë së Përkohshme të Kosovës nga 1999 2000.

Hashim Thaçi ka qenë anëtar i Këshillit të Përkohshëm Administrativ (KPA), strukturë kjo e përbashkët qeverisëse e Misionit të OKB-së në Kosovë (UNMIK) dhe klasës politike kosovare, deri më 2001 kur u mbajtën zgjedhjet e para parlamentare në Kosovën e pasluftës.

Në tetor të vitit 1999, Hashim Thaçi ishte ndër themeluesit e Partisë së Progresit Demokratik të Kosovës (PPDK). Në kuvendin e parë zgjedhor të partisë, në vitin 2000, partia e ndryshoi emrin

në Partia Demokratike e Kosovës, ndërsa Hashim Thaçi u zgjodh kryetar i saj, post të cilin e mbajti deri më 26 shkurt 2016.

Hashim Thaçi ishte anëtar i Ekipit të Unitetit që përfaqësoi Kosovën në procesin negociator të udhëhequr nga Emisari Special i OKB-së, Presidenti Martti Ahtisaari, që negocioi statusin politik të Kosovës, 2005 – 2007.

Pas fitores së Partisë Demokratike të Kosovës në zgjedhjet parlamentare të 17 nëntorit 2007, Hashim Thaçi u zgjodh Kryeministër i Qeverisë së Kosovës. Kurse, më 17 shkurt 2008, kryeministri Hashim Thaçi në Kuvendin e Kosovës shpalli Kosovën shtet të pavarur.

Thaçi është kryeministri i parë i Qeverisë së Republikës së Kosovës.

Përvoja akademike

Hashim Thaçi ka diplomuar në Degën e Historisë në Universitetin e Prishtinës. Studimet post-diplomike në fushën e Historisë së Evropës Juglindore dhe Shkencave Politike i ka bërë në Universitetin e Cyrihut në Zvicër (1996 – 1998).

Angazhimi i ish presidentit Hashim Thaçi për çështjen e Kosovës, në të gjitha nivelet, përgjatë dekadave, është për t'u vlerësuar me titullin “Qytetar nderi” i komunës së Drenasit.



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komuna e Drenasit
Zyra e Kryetarit



Nr 01-070101-60694 dt. 18/12/2023

Në bazë të nenit 58 paragrafi 1 pika (h) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040, nenit 72 të Statutit të Komunës së Drenasit, Kryetari i Komunës së Drenasit, propozon: Në bazë të nenit 11, 12 paragrafi 1, nenit 40, paragrafi 2 pika h, të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, nenit 3, pika 3.5 të Statutit të Komunës së Drenasit, Kuvendi i Komunës së Drenasit në mbledhjen e mbajtur më ____12.2023, të aprovojë këtë:

PROPOZIM VENDIM

Për shpalljen e z. Kadri Veseli, "Qytetar Nderi" i Komunës së Drenasit

Neni 1

Me këtë Propozim Vendim, i propozohet Kuvendit të Komunës shpallja e z. Kadri Veselit "Qytetar Nderi" i Komunës së Drenasit.

Neni 2

Titulli "Qytetar Nderi" për z. Kadri Veseli i jepet për kontributin e tij në luftën çlirimtare, shtetformim e shtetndërtim, procese historike që ka kaluar Kosova.

Neni 3

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës së Drenasit.

Neni 4

Ky vendim hyn në fuqi nga dita e miratimit nga Kuvendi i Komunës dhe vlerësimit të ligjshmërisë nga ana e MAPL-së.


Kryetari i Komunës
Edmir Lladrovci

ARSYETIM

Kadri Veseli

Kadri Veseli u lind më 31 maj të vitit 1967 në Mitrovicë. Shkollimin fillor dhe të mesëm e kreu në Mitrovicë e Zveçan, për të vazhduar më pas studimet në Prishtinë në vitin 1990 në Fakultetin e Bujqësisë si dhe në Shkollën e lartë Pedagogjike Doga Letërsi dhe Gjuhë Shqipe.

Por për shkak të rrethanave politike të asaj kohe për shkak të okupimit serb ishte detyruar që të vazhdoj studimet në Universitetin e Tiranës, në degën e Agronomisë.

Aktivitetin atdhetar dhe politik ai e nisi si student më 1988-1989, në radhët e Lëvizjes Popullore për Republikën e Kosovës duke u bërë njëri prej organizatorëve të protestave dhe demonstratave që zhvilloheshin në atë kohë kundër sistemit serb dhe jugosllav.

Në vitin 1990 bashkë me presidentin aktual Hashim Thaçin, bien në kontakt me udhëheqësin e atëhershëm të Ilegales, Afrim Zhitia. Më 1991 ai kalon ilegalisht në Shqipëri me mision të organizatës që kishte si qëllim zgjerimin dhe intensifikimin e veprimeve politike.

Në Tiranë takohet edhe me Grupin e Prekazit me në krye komandantin Adem Jashari dhe bashkë me të realizojnë aksionet e para të armatosura kundër policisë dhe ushtrisë serbe në Kosovë.

Prej vitit 1993 deri më 1998, Kadri Veseli bashkërendon aktivitetet rreth luftës së armatosur që nga Zvicra, Shqipëria, zona e Dukagjinit, Drenica, Pashtriku, etj.

Pas rënies së Jasharëve në mars të vitit 1998, Kadri Veseli, bashkë me anëtarë të tjerë të Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së, punojnë në strukturimin e njësive dhe formacioneve ushtarake nëpër të gjitha zonat operative.

Në këtë kohë ai emërohet komandat i Shërbimit të Zbulim Kundërzbulimit (G-2) të UÇK-së, përgjegjësi të cilën do ta ushtrojë deri në përfundim të luftës, raporton rtv Dukagjini.

Veseli në luftë ishte njohur me nofkën "Luli". Por pas çlirimit të Kosovës më 12 qershor 1999, krahas njësive të tjera të UÇK-së edhe shërbimi i Zbulim Kundërzbulimit (G-2), vendoset në Prishtinë për ta vazhduar misionin në rrethana të reja.

Në kushtet e paqes shërbimi ushtarak i Kundërzbulimit, u transformua në shërbim të inteligjencës. Ky edhe ishte formacioni i fundit i UÇK-së, pas Trupave Mbrojtëse të Kosovës i cili u shua vetëm pas shpalljes së Pavarësisë së Kosovës, më 17 Shkurt 2008.

Në fund të viti 2012, Kadri Veseli anëtarësohet në PDK, në vitin 2016 votohet për kryetar të PDK-së, kurse në vitin 2017 për kryetar të Kuvendi të Kosovës.

Andaj, angazhimi i z. Kadri Veseli për çështjen e Kosovës përgjatë dekadave, është për t'u vlerësuar me titullin "Qytetar nderi" i komunës së Drenasit.



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komuna e Drenasit
Zyra e Kryetarit



Nr 01-070101-60695 dt. 18/12/ 2023

Në bazë të nenit 58 paragrafi 1 pika (h) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040, nenit 72 të Statutit të Komunës së Drenasit, Kryetari i Komunës së Drenasit, propozon: Në bazë të nenit 11, 12 paragrafi 1, nenit 40, paragrafi 2 pika h, të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, nenit 3, pika 3.5 të Statutit të Komunës së Drenasit, Kuvendi i Komunës së Drenasit në mbledhjen e mbajtur më ____12.2023, të aprovojë këtë:

PROPOZIM VENDIM

Për shpalljen e z. Jakup Krasniqi, "Qytetar Nderi" i Komunës së Drenasit

Neni 1

Me këtë Propozim Vendim, i propozohet Kuvendit të Komunës shpallja e z. Jakup Krasniqi "Qytetar Nderi" i Komunës së Drenasit.

Neni 2

Titulli "Qytetar Nderi" për z. Jakup Krasniqi i jepet për kontributin e tij në shtetformim e shtetndërtim dhe proceset historike që ka kaluar Kosova.

Neni 3

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës së Drenasit.

Neni 4

Ky vendim hyn në fuqi nga dita e miratimit nga Kuvendi i Komunës dhe vlerësimit të ligjshmërisë nga ana e MAPL-së.


Kryetari i Komunës
Ramir Lladrovci

ARSYETIM

Jakup Krasniqi

Krasniqi i lindur me 1 janar 1951 në fshatin Negrovç të komunës së Drenasit, qysh herët kishte nisur aktivitetin ilegal për lirinë dhe pavarësinë e Kosovës.

Pasi kishte mbaruar shkollën fillore në vendlindje dhe të mesmën në Drenas, Krasniqi, studimet i mbaroi në Prishtinë, në Fakultetin Filozofik, dega Histori.

Më pas kthehet në vendlindje dhe nga viti 1972 deri në vitin 1977 punon si arsimtar në Negrovç dhe Arllat, ndërsa, në vitet 1976-1977 punon edhe si arsimtar në Shkollën e Mesme në Drenas. Po ashtu Krasniqi kishte punuar në vitet 1979–1981 Arsimtar në Arllat dhe pastaj në Shkollën e Mesme në Skenderaj, kurse me 1991–1994 Arsimtar në gjimnazin “Skënderbeu” në Drenas.

Gjatë kohës sa punonte si mësues, Krasniqi ishte marrë edhe me aktivitete politike në ilegalitet. Për këto aktivitete, Krasniqi në vitin 1981 ishte burgosur nga pushteti i atëhershëm serb, ku kishte qëndruar deri në vitin 1991.

Krasniqi gjatë vitit 1995–1998 ka qenë edhe kryetar i Këshillit të Arsimit në Drenas. Ndërsa, ka qenë edhe anëtar i Lidhjes Demokratike të Kosovës, deri në luftën e fundit.

Krasniqi kishte rol të rëndësishëm në krijimin e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Gjatë luftës, ai ishte anëtar i Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së, ku më pas ishte emëruar zëdhënës i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës gjatë viteve 1998-1999.

Si anëtar i Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së, Krasniqi ishte pjesë e delegacionit të Kosovës në konferencën e Rambujesë, në Francë, e cila i dha fund luftës me bombardimin e Serbisë nga NATO për 78 ditë me radh, nga 24 marsi deri me 12 qershor kur kishin hyrë në Kosovë forcat paqeruajtëse. Më përfundimin e luftës, Krasniqi ishte bashkuar me bashkëluftetarët për të themeluar Partinë Demokratike të Kosovës, pjesë e së cilës ishte deri në vitin 2014.

Në vitin 2001, në zgjedhjet e para parlamentare të pasluftës, Krasniqi ishte zgjedhur deputet i legjislaturës së parë. Ndërsa, pas formimit të Qeverisë së parë, të udhëhequr nga Bajram Rexhepi, Krasniqi ishte bërë ministër i Shërbimeve Publike.

Deputet ishte zgjedhur sërish në vitin 2004, në zgjedhjet parlamentare që ishin zhvilluar atë kohë, ku ishte emëruar shef i grupit parlamentar të PDK-së.

Me ardhjen e PDK-së në pushtet në vitin 2008, pas zgjedhjeve që ishin mbajtur në nëntor të vitit 2007, Krasniqi ishte zgjedhur në krye të Kuvendit të Kosovës.

Krasniqi ishte zgjedhur sërish në krye të Kuvendit në vitin 2010 pas zgjedhjeve parlamentare.

Në vitin 2014, pas disa përplasjeve me bashkëpartiakët, Krasniqi i ndan rrugët me PDK-në, duke formuar Nismës për Kosovën, bashkë me Fatmir Limajn dhe disa aktivist të kësaj partie.

Krasniqi zgjidhet kryetar i Këshillit Kombëtar të Nismës për Kosovën, e cila më vonë ndërron emrin dhe bëhet Nisma Socialdemokrate e Kosovës.

Kjo biografi e dëshmon se motivimi për ta shpallur “Qytetar Nderi” të Drenasit është meritë.



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komuna e Drenasit
Zyra e Kryetarit



Nr 01-070101-60697 dt. 18/12/2023

Në bazë të nenit 58 paragrafi 1 pika (h) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040, nenit 72 të Statutit të Komunës së Drenasit, Kryetari i Komunës së Drenasit, propozon: Në bazë të nenit 11, 12 paragrafi 1, nenit 40, paragrafi 2 pika h, të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, nenit 3, pika 3.5 të Statutit të Komunës së Drenasit, Kuvendi i Komunës së Drenasit në mbledhjen e mbajtur më ____12.2023, të aprovojë këtë:

PROPOZIM VENDIM

Për shpalljen e z. Rexhep Selimi, “Qytetar Nderi” i Komunës së Drenasit

Neni 1

Me këtë Propozim Vendim, i propozohet Kuvendit të Komunës shpallja e z. Rexhep Selimi “Qytetar Nderi” i Komunës së Drenasit.

Neni 2

Titulli “Qytetar Nderi” për z. Rexhep Selimi i jepet për kontributin e tij në çlirimin e vendit, shtetformimin dhe shtetndërtimin e Kosovës si dhe për proceset historike që ka kaluar Kosova.

Neni 3

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës së Drenasit.

Neni 4

Ky vendim hyn në fuqi nga dita e miratimit nga Kuvendi i Komunës dhe vlerësimit të ligjshmërisë nga ana e MAPL-së.

Kryetari i Komunës
Ramiz Lladrovci

ARSYETIM

Rexhep Selimi

Veprimtar, ish-komandant i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Ka lindur më 15 Mars 1971 në Aqarevë, Skenderaj.

Shkollimin fillor e kreu në Klinë, të mesmin në QAMO “Luigj Gurakuqi” në Klinë. Studimet universitare i kreu në Fakultetin Filologjik të Universitetit të Prishtinës, dega Letërsi dhe Gjuhë Shqipe.

Rexhep Selimi është themelues i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, dhe anëtar i Shtabit të Përgjithshëm. Rexhep Selimi më 28 Nëntor 1997 ka bërë paraqitjen e parë publike të UÇK-së në Llaushë të Skenderajt. Në 1998 ka qenë drejtues i Drejtorisë së operacioneve në SHP të UÇK-së. Më pas, Selimi ka qenë Inspektor i Përgjithshëm i UÇK-së. Gjatë viteve 1999- 2000 ka qenë Ministër i Rendit Publik në Qeverinë e Përkohshme të Kosovës.

Nga viti 2000 deri në 2003 Rexhep Selimi ka qenë Komandant i Akademisë së Mbrojtjes dhe Komandant i Komandës së Trajnimit dhe Doktrinës në TMK. Rexhep Selimi ka gradën gjeneral major.

Pas largimit nga AAK-ja, disa vite me vone pra në vitin 2010 i bashkohet Lëvizjes Vetëvendosje! dhe zgjidhet deputet i Lëvizjes. Ai gjatë mandatit 2011-2014 ka qenë anëtar i Komisionit parlamentar për Siguri, Punë të mbrendshme dhe mbikqyrje të FSK-së, ndërsa më 2019, Shef i Grupit Parlamentar të Vetëvendosjes!



Republika e Kosovës

Komuna e Drenasit

Kuvendi i Komunës



02 Nr. 052/01-59979 dt. 13/12/ **2023**

PLAN I PUNËS

SHËNJESEMI TË KOMUNËS SË DRENASIT PËR VITE

2024

Dhjetor, 2023

PLANI I PUNËS

SË KUVENDIT TË KOMUNËS SË DRENASIT PËR VITIN 2024

Pasqyra e planit

Parathënie.....	02
Janar.....	05
Shkurt.....	06
Mars.....	07
Prill.....	08
Maj.....	09
Qershor.....	10
Korrik.....	11
Gusht.....	12
Shtator.....	13
Tetor.....	14
Nëntor.....	15
Dhjetor.....	16

Parathënie

Kuvendi i Komunës është organi më i lartë në komunë dhe zgjidhet drejtpërdrejt nga qytetarët. Punën dhe aktivitetin e vet e mbështet në Ligjin për Vetëqeverisje Lokale, Statutin e Komunës dhe akte të tjera nënligjore. Siguron kushte të punës për seanca të Kuvendit, si dhe pjesëmarrje për qytetarët gjatë seancave. Siguron transparencë të plotë ndaj qytetarëve, për të gjitha vendimet dhe aktet, si dhe çdo gjë në interes të qytetarëve. Po ashtu, iu krijon mundësi qytetarëve që përmes formave të ndryshme të jenë pjesëmarrës në vendimmarrje.

Kuvendi i Komunës nxjerr akte të rëndësishme për Komunën siç janë:

- Statuti i Komunës
- Rregullorja e Punës
- Rregulloret komunale dhe çdo akt tjetër të nevojshëm apo të duhur për funksionim normal të komunës

Përveç këtyre akteve, Kuvendi i Komunës kryen edhe funksione të tjera dhe detyra të pa deleguara:

- Miraton Planin Vjetor të Punës
- Themelon komisione sipas ligjit
- Merr vendime për krijimin dhe përdorimin e dekoratave dhe titujve të nderit të komunës, në pajtim me ligjin në fuqi
- Bën emërimin, riemërimin e rrugëve, rrugicave dhe vendeve të tjera publike
- Arrin marrëveshje ndër komunale dhe brenda komunale
- Merr vendime për t'u bashkuar me asociacione përfaqësuese të komunave të Republikës së Kosovës, si dhe përgjegjësit të tjera të përcaktuara me ligj.

Plani i Punës i Kuvendit të Komunës së Drenasit për vitin 2024

Plani i punës së Kuvendit ka për qëllim planifikimin paraprak të punës për vitin 2024 dhe i bashkërenditur me aktivitetet e Planit të Punës së Kryetarit të Komunës për vitin 2024. Plani i Punës e përmbledh punën një vjeçare të Kuvendit, duke përfshirë të gjitha punët dhe aktivitetet, ndërsa çështjet të cilat nuk mund të planifikohen dhe dalin si nevoja për shqyrtim në Kuvend, do të trajtohen sipas ligjit për vetëqeverisje lokale, Statutit të Komunës së Drenasit dhe Rregullores së Punës së Kuvendit të Komunës së Drenasit. Në këtë mënyrë, në Planin e Punës janë paraparë 11 mbledhje të rregullta që do të mbahen për vitin 2024 mbledhjet do të mbahen javën e fundit të çdo muaji, përjashtimisht në rast kur mund të përcaktohet ndryshe.

Planifikimi i mbledhjeve të KK –së dhe çështjet që do të trajtohen gjatë vitit 2024

Shtojcë: *Plani i punës sipas muajve*

PLANI I PUNËS SË KUVENDIT TË KOMUNËS SË DRENASIT PËR VITIN 2024
JANAR 2024

Nr	OBJEKTIVAT	ORGANI PËRQJEGJËS		Afati i procedimit	Shqyrtimi paraprak	Shqyrtimi në Kuvend	AKTIVITETET Afati kohor
		Dytësor	Parësor				
1.	Raporti vjetor i buxhetit për vitin 2023	DF	Kryetari i Komunës	17.01.2024	KPF 24.01.2024	31.01.2024	
2.	Raportet e Komiteteve Konsultative në KPF	Komitetet Konsultative	Kuvendi i Komunës	17.01.2024	KPF 24.01.2024	31.01.2024	
3.	Trajtimi i çështjeve tjera të proceduara për Kuvend nga Kryetari, anëtarët e Kuvendit dhe qytetarët	Drejtoritë Profesionale	Kryetari i Komunës	17.01.2024	KPF 24.01.2024	31.01.2024	

PLANI I PUNËS SË KUVENDIT TË KOMUNËS SË DRENASIT PËR VITIN 2024

SHKURT 2024

Nr.	OBJEKTIVAT	ORGANI		Afati i procedimit	Shqyrtimi paraprak	Shqyrtimi në Kuvend	AKTIVITETET
		Dytësor	Parësor				
1.	Raporti i Kryetarit të Komunës për vitin 2023.	Drejtorinë profesionale	Kryetari i Komunës	14.02.2024	KPF 21.02.2024	28.02.2024	17.02.2024
2.	Plani i veprimt për transparencë për vitin 2023.	Drejtorinë Profesionale	Kryetari i Komunës		KPF 21.02.2024		MBLEDHJE SOLEMNE TË KUVENDIT TË KOMUNËS PËR NDERË TË 17 SHKURTIT, DITËS SË SHPALLES SË PAVARSISË SË KOSOVËS
3.	Trajtimi i gëshqjeve tjera të proceduara për Kuvend nga Kryetari, anëtarët e Kuvendit dhe qytetarët	Drejtorinë Profesionale	Kryetari i Komunës		KPF 21.02.2024		
4.							
5.							

PLANI I PUNËS SË KUVENDIT TË KOMUNËS SË DRENASIT PËR VITIN 2024

MARS 2024

Nr.	OBJEKTIVAT	ORGANI PËRGJEGJËS		Afati i procedimit	Shqyrtimi paraprak	Shqyrtimi në Kuvend AKTIVITETET Afati kohor	05.03.2023
		Dytësor	Parësor				
1.	Plani i veprimt për transparence për vitin 2023	Drejtoritë Profesionale	Kryetari i Komunës	13.03.2024	KPF 20.03.2024	27.03.2024	Mbledhje Solemne e Kuvendit të Komunës Drenas kushtuar "Epopesë së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Rënies Heroike të Komandantit Legjendar Adem Jashari, familjes Jashari dhe të
2.	Trajtimi i gëshjave tjera të proceduara për Kuvend nga Kryetari, anëtarët e Kuvendit dhe qytetarët	Drejtoritë Profesionale	Kryetari i Komunës	13.03.2024	KPF 16.03.2024	27.03.2024	

PLANI I PUNËS SË KUVENDIT TË KOMUNËS SË DRENASIT PËR VITIN 2024

PRILL 2024

Nr.	OBJEKTIVAT	ORGANI		Afati i procedimit	Shqyrtimi paraprak	Shqyrtimi në Kuvend	AKTIVITETET Afati kohor
		Dytësor	Parësor				
1.	Raporti financiar për tre mujo rin e viti 2024	DF	Kryetari i Komunës	16.04.2024	KPF 23.04.2024	30.04.2024	9 Prill Dita e Kushtetutës së Republikës së Kosovës
2.	Trajtimi i çështjeve tjera të proceduara për Kuvend nga Kryetari, anëtarët e Kuvendit dhe qytetarët	Drejtoritë Profesionale	Kryetari i Komunës	16.04.2024	KPF 23.04.2024	30.04.2024	
3.							
4.							

PLANI I PUNËS SË KUVENDIT TË KOMUNËS SË DRENASIT PËR VITIN 2024

Maj 2024

Nr.	OBJEKTIVAT	ORGANI PËRQJEGJËS		Afati i procedimit	Shqyrtimi paraprak	Shqyrtimi në Kuvend	AKTIVITETE T Afati kohor
		Dytësor	Parësor				
1.	Informat lidhur me qarkoren Buxhetore 2024 dhe planifikimi i veprimit për dëgjime Publike	DF	Kryetari i Komunës	15.05.2024	KPF 22.05.2024	29.05.2024	1 Maj Dita Ndërkombëtare Punës
2.	Trajtimi i çështjeve tjera të proceduara për Kuvend nga Kryetari, anëtarët e Kuvendit dhe qytetarët	Drejtorinë Profesionale	Kryetari i Komunës	15.05.2024	KPF 22.05.2024	29.05.2024	9 Maj Dita e Evropës
3.							
4.							

PLANI I PUNËS SË KUVENDIT TË KOMUNËS SË DRENASIT PËR VITIN 2024

QERSHOR 2024

Nr	OBJEKTIVAT	ORGANI PËRGJEGJËS		Afati i procedimit	Shqyrtimi paraparak	Shqyrtimi në Kuvend	AKTIVITETE T Afati kohor
		Dytësor	Parësor				
1.	Draft – korniza afatmesme buxhetore (KAB) për vitet 2024-2025	DF	Kryetari i Komunës	13.06.2024	KPF 20.06.2024	27.06.2024	MBLEDHJEN SOLEMNE TË KUVENDIT TË KOMUNËS PËR NDERË TË 14 QERSHORIT, DITËS SË ÇLIRIMIT TË DRENASIT
2.	Trajtimi i çështjeve tjera të proceduara për Kuvend nga Kryetari, anëtarët e Kuvendit dhe qytetarët	Drejtoria Profesional e	Kryetari i Komunës	13.06.2024	KPF 20.06.2024	27.06.2024	
3.							
4.							

PLANI I PUNËS SË KUVENDIT TË KOMUNËS SË DRENASIT PËR VITIN 2024

KORRIK 2024

Nr.	OBJEKTIVAT	ORGANI PËRSGJEGJËS		Afati i procedimit	Shqyrtimi paraprak	Shqyrtimi në Kuvend	AKTIVITETET Afati kohor
		Dytësor	Parësor				
1.	Raporti gjashtë mujor i Kryetarit të Komunës se Drenasit për vitin 2024	Drejtoritë	Kryetari i Komunës	17.07.2024	KPF 24.07.2024	31.07.2024	
2.	Raporti i Auditorit të Jashtëm për vitin 2023 për Komunën e Drenasit (Glllogocit)		Kryetari i Komunës				
3.	Trajtimi i çështjeve tjera të proceduara për Kuvend nga Kryetari, anëtarët e Kuvendit dhe qytetarët	Drejtoritë Profesionale	Kryetari i Komunës				
4.							
5.							

PLANI I PUNËS SË KUVENDIT TË KOMUNËS SË DRENASIT PËR VITIN 2024

Gusht, 2024

Nr.	OBJEKTIVAT	ORGANI PËRGJEGJËS		Afati i procedimit	Shqyrtimi paraprak	Shqyrtimi në Kuvend	AKTIVITETET Afati kohor
		Dytësor	Parësor				
6.	Raporti gjashtë mujor i Kryetarit të Komunës së Drenasit për vitin 2023	Drejtoritë	Kryetari i Komunës	14.08.2024	KPF 21.08.2024	28.08.2024	
7.	Raporti i Auditorit të Jashtëm për vitin 2023 për Komunën e Drenasit (Glllogocit)		Kryetari i Komunës				
8.	Trajtimi i çështjeve tjera të proceduara për Kuvend nga Kryetari, anëtarët e Kuvendit dhe qytetarët	Drejtoritë Profesionale	Kryetari i Komunës				
9.							
10.							

PLANI I PUNËS SË KUVENDIT TË KOMUNËS SË DRENASIT PËR VITIN 2024

SHTATOR 2024

Nr.	OBJEKTIVAT	ORGANI PËRGJEGJËS		Afati i procedimit	Shqyrtimi paraprak	Shqyrtimi në Kuvend	AKTIVITETE T Afati kohor
		Dytësor	Parësor				
1.	Raporti gjashtë mujor financiar i Komunës se Drenasit për vitin 2023	DF	Kryetari i Komunës	12.09.2024	KPF 19.09.2024	26.09.2024	
2.	Shqyrtimi i Draft -Buxheit final, dhe marrja e vendimit për buxhet për vitet 2023-2025	DF	Kryetari i Komunës	12.09.2024	KPF 19.09.2024	26.09.2024	
3.	Trajtimi i gëshfjeve tjera të proceduara për Kuvend nga Kryetari, anëtarët e Kuvendit dhe qytetarët	Drejtorit profesiona le	Kryetari i Komunës	12.09.2024	KPF 19.09.2024	26.09.2024	
4.							
5.							
6.							

PLANI I PUNËS SË KUVENDIT TË KOMUNËS SË DRENASIT PËR VITIN 2024

TETOR 2024

Nr	OBJEKTIVAT	ORGANI PËRGJEGJËS		Afati i procedimit	Shqyrtimi paraparak	Shqyrtimi në Kuvend	AKTIVITET ET Afati kohor
		Dytësor	Parësor				
1.	Raporti nëntë mujor i realizimit të buxhetit të Komunës së Drenasit për vitin 2023	Drejtoritë	Kryetari i Komunës	16.10.2024	KPF 23.10.2024	30.10.2024	
2.	Trajtimi i gëshfjeve tjera të proceduara për Kuvend nga Kryetari, anëtarët e Kuvendit dhe qytetarët	Drejtoritë	Kryetari i Komunës	16.10.2024	KPF 23.10.2024	30.10.2024	
3.							
4.							

PLANI I PUNËS SË KUVENDIT TË KOMUNËS SË DRENASIT PËR VITIN 2024

NËNTOR 2024

Nr.	OBJEKTIVAT	ORGANI PËRGJEGJËS		Afati i procedimit	Shqyrtimi paraparak	Shqyrtimi në Kuvend	AKTIVITETET Afati kohor
		Dytësor	Parësor				
1.	Informatë nga Drejtoria e Urbanizmit, Drejtoria e shërbimeve Publike dhe Drejtoria e Arsimit rreth realizimit të përfundimit të projekteve kapitale në teren	Drejtoritë	Kryetari i Komunës	13.11.2024	KPF 20.11.2024	27.11.2024	28 Nëntor SEANCË SOLEMNE TË KUVENDIT TË KOMUNËS ME RASTIN E FESTËS SË 28 NËNTORT, DITËS SË FLAMURIT, DITËLINDJES SË KOMANDANTIT LEGJENDAR ADEM JASHARI
2.	Trajtimi i çështjeve tjera të proceduara për Kuvend nga Kryetari, anëtarët e Kuvendit dhe qytetarët	Drejtoritë	Kryetari i Komunës	13.11.2024	KPF 20.11.2024	27.11.2024	
3.							
4.							
5.							

PLANI I PUNËS SË KUVENDIT TË KOMUNËS SË DRENASIT PËR VITIN 2024

DHJETOR 2024

Nr.	OBJEKTIVAT	ORGANI PËR GJEGJËS		Afati i procedimit	Shqyrtimi paraprak	Shqyrtimi në Kuvend	AKTIVITETET Afati kohor
		Dytësor	Parësor				
1.	Plani i punës i Kuvendit të Komunës për vitin 2025	Kryetari i Komunës	Kuvendi i Komunës	11.12.2024	KPF 18.12.2024	25.12.2024	
2.	Plani i Punës i Kryetarit të Komunës për vitin 2025	Drejtoritë përkatëse	Kryetari i Komunës	11.12.2024	KPF 18.12.2024	25.12.2024	
3.	Trajtimi i çështjeve tjera të proceduara për Kuvend nga Kryetari, anëtarët e Kuvendit dhe qytetarët	Drejtoritë	Kryetari i Komunës	11.12.2024	KPF 18.12.2024	25.12.2024	

Kuvendi i Komunës së Drenasit ka planifikuar që gjatë vitit 2024, të mbaj gjithsej 12 mbledhje, këtij Plani ja bashkëngjisim edhe orarin e takimeve që do të mbahen për secilin muaj.

DRENAS – 05.12.2023

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

Milaim Hajdari



Republika e Kosovës
Komuna e Drenasit
Kuvendi i Komunës



Nr. 02-052/01-59999 dt. 13/12 2023

Në bazë të Ligjit nr. 03/L-40 për Vetëqeverisje Lokale, të Statutit të Komunës së Drenasit, dhe rregullores për punën e Kuvendit të Komunës, Kuvendi i Komunës së Drenasit për vitin 2024 planifikoi këtë:

Orari i mbledhjeve të Komitetit për Politikë dhe Financa dhe i mbledhjeve të Kuvendit Komunal për vitin 2024.

Janar Mbledhja e KPF-a me 24.01.2024 ora 10:00 Mbledhja e Rregullt e KK me dt. 31.01.2024	Shkurt Mbledhja e KPF-a me dt. 21.02.2024 ora 10:00 Mbledhja e Rregullt e KK me dt. 28.02.2024	Mars Mbledhja e KPF-a me dt. 20.03.2024 ora 10:00 Mbledhja e Rregullt e KK me dt. 27.03.2024
Prill Mbledhja e KPF-a me dt. 23.04.2024 ora 10:00 Mbledhja e Rregullt e KK me dt. 30.04.2024	Maj Mbledhja e KPF-a me dt. 22.05.2024 ora 10:00 Mbledhja e Rregullt e KK me dt. 29.05.2024	Qershor Mbledhja e KPF-a me dt. 20.06.2024, ora 10:00 Mbledhja e Rregullt e KK me dt. 27.06.2024
Korrik Mbledhja e KPF-a me dt. 24.07.2024, ora 10:00 Mbledhja e Rregullt e KK me dt. 31.07.2024	Gusht Mbledhja e KPF-a me dt. 23.08.2024, ora 10:00 Mbledhja e Rregullt e KK-al me 30.08.2023	Shtator Mbledhja e KPF-a me 19.07.2024, ora 10:00 Mbledhja e Rregullt e KK-al me 26.09.2024
Tetor Mbledhja e KPF-a me 23.10.2024 ora 10:00 Mbledhja e Rregullt e KK me dt. 30.10.2024	Nëntor Mbledhja e KPF-a me 20.11.2024, ora 10:00 Mbledhja e Rregullt e KK-al me 27.11.2024	Dhjetor Mbledhja e KPF-a me 18.12.2024, ora 10:00 Mbledhja e Rregullt e KK-al me 25.12.2024

DRENAS, 13.12.2023

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

Milaim Hajdari



REPUBLIKA E KOSOVËS

Komuna e Drenasit

Nr. 0A-400/01-59589

Dt. 12/12/2023



LISTA E RREZIQEVE KOMUNALE PËR VITIN 2024

Nr.	Objektiva	Rreziku	Drejtorati	Lloji i rrezikut	Shkalla	Aktivitetet për menaxhimin e rrezikut	Bartësit e aktivitetit	Afati i implementimit
1	Përgatitja e buxhetit komunal dhe kornizës afatmesme buxhetore	Vonesa në përgatitja me kohë e propozim buxhetit Komunal	DBF	Operacional	M	ZKF dhe Shefi i sektorit për buxhet dhe financa, Analisti i buxhetit duke u bazuar në qarkoret buxhetore të nxjerrë nga MFPT-ë, dhe duke zbatuar të gjitha instruksionet e dhëna	ZKF	Muaji shtator 2024
2	Hartimi i planit kesh të zotimeve dhe shpenzimeve dhe dorëzimi në MFPT-ë	Vonesa në përgatitje të planit të zotimit dhe shpenzimit dhe dorëzimi në Thesar.	DBF	Operacional	M	Pas aprovimit të buxhetit komunal shefi i sektorit në bashkëpunim me programet dhe nënprogramet në janar obligohet të hartojë planin kesh dhe të njëjtin ta dorëzojë në Thesar.	Shefi i sektorit për buxhet e financa	Janar 2024
3	Hartimi i raporteve	Vonesa në përgatitja me	DBF	Legjis	M	Menaxhimi i këtij rreziku ZKF dhe	ZKF, shefi i	Në janar

	të rregullta dhe periodike e vjetore për shpenzimin e buxhetit	kohë e Pasqyrave Vjetore Financiare		ativ	stafi i Drejtorisë për buxhet dhe financa dhe duke u bazuar në UA të lëshuar nga D.Thesarit, fillojnë aktivitetet për hartimin e PVF në janar të viti vijues.	sektorit dhe analisti i buxhetit	të vitit 2024.
4	Identifikimi dhe regjistrimi i pasurive të Komunës	Vonesa në regjistrimin me kohë i pasurive të Komunës	DBF	Legjislativ dhe administrativ	Zyrtari i pasurisë dhe zyrtari i pranimi të mallit pas qdo blerje zyrtari i pasurisë dhe zyrtari i pranimi duhet të regjistrojnë të gjitha blerjet mbi 1000 në SIMFK dhe nën 1000 euro në sistemin E- pasurisë E-pasuria.	Zyrtari i pasurisë dhe analisti i pranimi të mallit	Gjatë tërë vitit.
5	Inkasimi me kohë dhe i sakt i të gjitha të hyrave	Mos inkasimi me koh sipas planifikimit i tatimit në pronë	DBF	Administrativ	Përgatitja dhe aprovimi me kohë i normave tatimore dhe shprehendatja e tyre, si dhe aktivitetet shtesë për inkasimin e shumës së planifikuar të tatimit në pronë, dërgimi i vërtetjeve, letër kujtesave dhe dërgimi i borxhlive në procedurë përbarimore.	Menagjeri i zyrës së tatimit në pronë dhe stafi	Gjatë tërë vitit fiskal
6	Pranimi me kohë i të gjitha faturave	Mos adresimi me kohë i faturave të pranuar për pagesë	DBF	Legjislativ	Mënyra e pranimi të faturave tanimë është rregulluar dhe të njëjtat pranimet për adresohen të njëjtat deri të shërbimi i pagesave.	Të gjithë mbanjtësit e buxhetit	Gjatë tërë vitit fiskal.
7	Realizimi i drejt i buxhetit komunal.	Pagesa e obligimeve të paguara	DBF	Legjislativ	Po punohet që asnjë kontratë mos të lidhet para se të zotohen mjetet, dhe të këtë buxhet të mjaftueshëm	Mbajtësit e buxhetit	Gjatë tërë vitit fiskal
8	Menagjimi me të pagueshmet	Detyrimet Kontigjente	DBF	Legjislativ	Të gjitha obligimet e vlerësuara nga ana e avokatit komunal si detyrime kontigjente, do vazhdojnë të kërkohen nga niveli qendror që të na lejohet masë buxhetore për mbulimin e tyre.	Zyra e kryetarit	I përkrahshëm
9	Sigurimi i zhvillimit ekonomik të	Mos njoftimi me kohë për ndryshimet e ligjeve në sferën ekonomike.	DZHE	Legjislativ	Drejtori i Drejtoratit si dhe Shefi i sektorit do të jenë përkrahës në rrjedhë të ndryshimeve tek stafi vartës përmes	Drejtori i Drejtoratit Shefi i	I përkrahshëm

	Komunës					shkresave të brendshme si njoftime dhe urdhëresa për zbatimin e proceseve të reja.	sektorit, dhe stafi përkatës.	
10	Krijimi i kushteve më të favorshme për investitorët e huaj.	Tërheqja e investimeve të huaja	DZHE	Strategjik	M	1. Rritja e investimeve përmes dhënies së pronës komunale në shfrytëzim. 2. Funksionalizimi i plotë i zonave ekonomike. 3. Negocimi i ofertave nga Kryetari i komunës me të gjithë personat fizik dhe juridik që shprehin interes për marrje të pronës në shfrytëzim për zhvillim të veprimtarisë biznesore.	Kryetari, Drejtoria për Zhvillim Ekonomik,	1 përher-shëm
11	Fuqizimi i sektorëve prodhues dhe përpunues në të bërit biznes.	Mungesa e investimeve kapitale në zhvillimin e sektorëve të ndryshme prodhues dhe përpunues si baze e mire për zhvillimit të mëtutjeshëm.	DZHE	Strategjik	M	1. Krijimi i kushteve më të favorshme në të bërit biznes.	Drejtoria për Zhvillim Ekonomik,	1 përher-shëm
12	Shfrytëzimi i resurseve në funksion të zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik	Identifikimi i zonave të reja për zhvillim të turizmit	DZHE	Strategjik	M	1. Përmirësimi i infrastrukturës lokale në zonat turistike 2. Numri i objekteve të menaxhuara dhe të mirëmbajtur nga komunat 3. Organizimi i panairëve për promovimin e turizmit 4. Evidentimi i hapësirave me rëndësi të trashëgimisë kulturore dhe funksionalizimi i tyre për vizita turistike 5. Krijimi i pikave informuese për promovimin e turizmit lokal 6. Promovimi i trashëgimisë kulturore dhe natyrore.	Drejtoria për Zhvillim Ekonomik, Shefi i sektorit dhe stafi përkatës. Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport	1-2 vite
13	Mbajtja e saktë e	Inkasimi jo i knaqshëmi i të	DZHE	Strategjik	L	1. Zhvillimi i politikave për	Drejtori dhe	1 përher-

	evidencave për bizneset	hyrave nga taksa për veprimtari të bizneseve ,adresar jo te sakta te bizneseve si dhe bizneset pasive.	, ,	jike		mundësinë e inkasimit të borxheve të akumuluarra për taksen komunale(falje, amnisti apo me marrëveshje) 2. Verifikimi i bizneseve aktive ne teren.	stafi përkatës. Drejtoria e Inspeksionit-Inspektori i Tregut.	shëm
14	Realizimi i Strategjisë se Zhvillimit Ekonomik Lokal 2020-2024	Vlerësimi Strategjisë se Zhvillimit Ekonomik ne baza vjetore	DZHE	Financiar, Strategjike	M	Plani i veprimit të Strategjisë do të rishikohet në baza vjetore në kuadër të planifikimit të monitorimit që përcaktohet në Strategji , dhënia e rekomandimeve nga komisioni.	Drejtoria për Zhvillim Ekonomik, Shefi i sektorit, komisioni komunal	4 vjeçar
15	Hartimi i Strategjisë së Zhvillimit Ekonomik	Mos Planifikimi i buxhetit në bazë të dokumenteve të planifikimit, strategjive dhe programeve komunale	DZHE	Financiar, Strategjike	M	Përfshirja në kornizën afatmesme buxhetore dhe koordinimi ne mes te sektorëve Plani i veprimit të Strategjisë do të rishikohet në baza vjetore në kuadër të planifikimit të monitorimit që përcaktohet në Strategji.	Drejtoria për Zhvillim Ekonomik ne bashkëpunim me te gjitha drejtorit. Komisioni komunal	5 vjeçar
16	Rritja e cilësisë dhe mbikëqyrjes në realizimin e projekteve	Menaxhimi i stafit gjatë implementimit të projekteve	DShPE	Menaxherial	U	Mbajtja e kontakteve me zyrtarët e prokurimit Koordinimi rreth punëve që lidhen me procedurat e prokurimit	DShPE	Gjatë gjithë vitit 2024
17	Rritja e kapaciteteve profesionale të zyrtarëve që menaxhojnë me projekte	Mungesa e zyrtarëve me kualifikime profesionale për menaxhim të kontratave.	DShPE	Menaxherial dhe financiar	U	Organizimi i trajnimeve lidhur për menaxhimin e kontratave dhe hartimin e planeve të menaxhimit për E-prokurim dhe të caktohen persona të kualifikuar	Drejtoria e Administratës Zyrtare e prokurimit dhe DShPE	TM1/2024
18	Kompletimi me kohë i stafit për	Vonesa në rekrutimin e stafit që kanë lëshuar punën	DShPE	Kontraktuale	L	Të bëhet azhurnimi me kohë i shpalljes se vendeve të lira dhe anyre të reja	DShPE Zyra e	Gjatë vitit 2024

	Drejtori		Zyra e personelit	I		të punës sipas afateve ligjore në SIMBNJ	kryetarit Zyra e personelit	
19	Kompletimi me paisje për funksionim të re-alizimit me sukses të projekteve.	Mungesa e mjeteve për punë në teren (automjetet, kamerë, Rotmeter, Fluksmeter etj).	Prokurimi	Financiar	U	Koordinimi i punëve zyrtare e prokurimit për blejjen e këtyre pajisjeve	Drejtorja e Aciministratës Zyra e Prokurimit dhe DShPE	TM1/2024
20	Përbushja me kohë e kontratave	Mos përbushja e kontratave nga ana e operatorit ekonomik sipas kushteve të përcaktuara në kontratë.	Prokurimi DShPE	Kontraktuar	M	Koordinim ndërmjet zyrtarëve nga DShPE-së, prokurimit dhe Operatorit Ekonomik	DShPE dhe prokurimi	I përher-shëm
21	Zbatimi i Planit të prokurimit, sipas planifikimeve të Drejtorive	Humbja e mjeteve buxhetore për shkak të vonesave kohore të zbatimit të procedurave të prokurimit dhe pagesave	Prokurimi DShPE	Financiar	M	Koordinimi i punëve ndërmjet Zyrtës së prokurimit, DShPE dhe DF. Mundësia që Plani KESH të modifikohet për rastet kur nuk kryhen me kohë procedurat e prokurimit dhe vonesa në realizim të projekteve	DShPE, Drejtorja për Buxhet dhe Financa	I përher-shëm
22	Rritje e kontrollit gjatë pranimit të mallrave	Mos furnizimi me mallra sipas kushteve të parapara me kontratë dhe pranimi i tyre.	Prokurimi dhe D.B.F.	Financiar dhe kontraktuar	M	Kontroll e rreptë e dosjeve dhe specifikave të kontratës.	DShPE dhe Prokurimi	I Përher-shëm
23	Hartimi me kohë i projektit zbatues/ideor dhe njoftimi i qytetarve në terren lidhur me projektet	Vështirësitë në realizimin e punëve në teren	DShPE	Menaxherial	M	Koordinim me stafin e DShPE-së, administratorëve të fshatrave dhe OE	DShPE	I Përher-shëm

24	Hjekja e pengesave në re-alizimin e projekteve, duke bërë përgaditjet e nevojshme të dokumentacionit/pronës, projektit e etj.	Pengesat dhe përballja me qytetarët rreth realizimit të projekteve, punëve në teren	DShP E dhe stafi	Strategjik	M	Koordinim në mesë të drejtorisë sonë me drejtorinë e Inspektoratit dhe drejtorinë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë	DShPE	I Përher-shëm
25	Përmirësimin e të kuptuarit të funksionit të kontrollit të brendshëm nga ana e menaxhmentit të Komunës.	Njohuritë e pa mjaftueshme të menaxhmentit në lidhje me vendosjen dhe funksionimin e kontrollave të brendshme në Komunë	NJAB	Strategjik	L	Kontrollat e vazhdueshme nga ana e NJAB-it në lidhje me vendosjen dhe funksionimin e kontrollave të brendshme	NJAB	I përher-shëm
26	Shfrytëzimi ekonomik, efikas dhe efektiv i të gjitha burimeve humane dhe materiale të Komunës	Ndërrimi i shpeshtë i stafit udhëheqës në Drejtorate	NJAB	Organizativ	M	Pas çdo vendosje të stafit të ri, duhet të sigurohemi se janë kuptuar në mënyrë të drejtë dhe në nivel të knaqshëm detyrat dhe përgjegjësitë e stafit të ri	NJAB	I përher-shëm
27	Ofrimi i sigurisë së arsyeshme për menaxhmentin në lidhje me aktivitetet dhe veprimet e tij	Mungesa e të kuptuarit të drejtë të nocionit të rrezikut nga ana e menaxherëve	NJAB	Strategjik	M	Ndihmë e vazhdueshme e menaxhmentit përmes shërbimeve konsulente me menaxherët	NJAB	I përher-shëm
28	Arritja e pajtueshmërisë me kornizën	Ndërrimi i shpeshtë i legjislationit i cili rregullon kompetencat komunale	NJAB	Legjislativ	L	Ofrimi i duhur i trajnimeve për shërbyesit civil në lidhje me zbatimin e normativës ligjore të re	Njësia e përsoneelit në bashkëpunim	I përher-shëm

	ligjore në fuqi							me të gjitha drejtoratet	
29	Menaxhim i drejtë dhe ruajtje e sigurtë e pronës komunale.	Keqpërdorimi dhe ruajtja e pa sigurtë e pronës komunale	NJAB	Reputacion/operativ	L	Ushtrimi i auditimeve të shpeshta në këtë fushë dhe rekomandimi për përmirësime dhe vendosje e funksionalizim të kontrollave të brendshme	NJAB	I përher-shëm	
3	Tavolinë për Hekurosje Profesionale me Krah Lëvizëse, me Vakum në Sipërfaqe (me nxemje,ftohje) FURKAN - Harmony brend	COPE	1	€ 450.00	€ 450.00
4	Hekur Profesionale SILTER - SUPER MINI 3.5Lit.	COPE	1	€ 230.00	€ 230.00
5	Manikene për Reklamim dhe Draping	COPE	1	€ 80.00	€ 80.00
				TOTALI ME TVSH	€ 1,780.00

Garancioni 12 muaj

Emri dhe nënshkrimi i shitësit

Banka : NLB Banka

Nr.llogarisë : 1705-0010-11986173

Ju faleminderit për bashkëpunim

Dku7.

Emri dhe nënshkrimi i blerësit



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Drenasit
Zyra e Kryetarit



01 Nr 400/01-59971 dt. 13/12/2023

Në bazë të nenit 50 paragrafi 1 të Ligjit për Procedurën Administrative, Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, Statutit të Komunës së Drenasit, Rregullorës 12 Nr.320-19338, të dt.07.04.2017, për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e ndarjes së Subvencioneve, si dhe rregulloren Nr.02-400/01-18380 të dt; 27.04.2022, Buxheti i miratuar nga Kuvendi i Komunës së Drenasit për vitin 2023, Kryetari i Komunës paraqet këtë:

PROPOZIM
PËR NDRYSHIM/KORIGJIM TË VENDIMIT PËR FINANCIMIN E PROJEKTIT

- I. **KORIGJOHET** pika 2 e Vendimit me Nr: 01 Nr:400/01/-50461 të dt: 11.10.2023 konkretisht përlllogaritja e shumës për përkrahje: 1,600.00 € ”
- II. **CAKTOHET** - Projekti Sabahate Gashi përkrahet me shumën prej **1,375.06 €** (njëmijë e treqindë e shtatëdhjet e pesë euro e gjashtë cent) të cilat mjete do të shfrytëzohen për mbulimin e shpenzimeve-blerjën e paisjeve, në vend të shumës prej: 1,600.00€.
- III. **KORIGJOHET** pika 3 e Vendimit, ndryshohet pjesa e tekstit: ndërsa transferi do të bëhet në xhirollogarinë me nr. **1300-0010-038426.12 B.P.B** të përfituesit në vend të tekstit, ndërsa transferi do të bëhet përmes xhirollogarisë me nr.XK051401000003002620 Banka Ekonomike.

Korrigjimi/Ndryshimi bëhet në përlllogaritje të shumës për përkrahje pasi që vërehet një mospërputhje mes kërkesës së shumës së projektit dhe shumës së llogaritur për përkrahje/subvencionim si dhe numrit të llogarisë bankare të përfituesit.

- IV. Pikat tjera të vendimit me Nr: 01 Nr:400/01/-50461 të dt: 11.10.2023 mbeten të pa ndryshuara.



Kryetari i Komunës
Ramiz Lladrovci



11/10/23		
Mj. Org.	Nr. Dreg.	50461
01	600/01	50461



REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA DRENAS
Zyra e Kryetarit

Në vështrim të nenit 58, paragrafi 1, nënparagrafi h të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 34.6 të Statutit të Komunës së Drenasit, Rregullorës 12 Nr.320-19338, të dt.07.04.2017, për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e ndarjes së Subvencioneve, si dhe rregulloren Nr.02-400/01-18380 të dt.27.04.2022, Buxheti i miratuar nga Kuvendi i Komunës së Drenasit për vitin 2023. Me propozim të Komisionit për Shqyrtimin dhe Vlerësimin e kërkesave për ndarje të subvencioneve 01Nr.400/01-47695 e dt.22.09.2023, përmes thirrjes publike Nr.05-400-44432 të dt.04.09.2023, Kryetari i Komunës paraqet këtë:

PROPOZIM
VENDIM PËR FINANCIMIN E PROJEKTIT

Neni 1

Propozohet mbështetja me mjete financiare për projektin/programin e **Sabahate Gashi** për mbështetje financiare për mbulimin e shpenzimeve-blerjen e paisjeve.

Neni 2

Projekti i Sabahate Gashi përkrahet me shumën prej **1.600.00 €** (njëmijë e gjashtëqind euro) të cilat mjete do të shfrytëzohen për mbulimin e shpenzimeve-blerjen e paisjeve.

Neni 3

Mjetet financiare për realizimin e këtij projekti të lejohen nga kategoria ekonomike e shpenzimeve, subvencioneve dhe transfereve, kodi ekonomik 21/611/48001/21200/00000/0411 të Drejtoratit për Zhvillim Ekonomik të Komunës ndërsa transferi do të bëhet përmes xhironlogarisë me nr.XK051401000003002620 Banka Ekonomike.

Neni 4

Ky propozim vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Drenasit dhe vlerësimi të ligjshmërisë nga ana e MAPL-së. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset : Kryetari i Komunës, Drejtoria për Buxhet dhe Financa dhe Drejtoria për Zhvillim Ekonomik .



Kryetari i Komunës
Ramiz Lladrovci

Arsyetim

Bazuar në thirrjen publike Nr.05-400-44432 të dt.04.09.2023 nga Drejtoria për Zhvillim Ekonomik për ndarjen e subvencioneve për Mikro biznese dhe Start-Up vitin 2023,projekti-kërkesa nr:05-070/01-45147 e dt.07.09.2023 për Sabahate Gashi me nr.personal 1030432513 për mbeshtetje financiare për mbulimin e shpenzimeve-blerjën e paisjeve.

Me propozim të Komisionit për Shqyrtimin dhe Vlerësimin e kërkesave për ndarje të subvencioneve, Kryetari i Komunës propozon Kuvendit përkrahjën me mjete financiare për biznesin ose personin në realizimin e projektit për mbeshtetje financiare për mbulimin e shpenzimeve-blerjën e paisjeve , në shumën prej 1.600.00 Euro.



REPUBLIKA E KOSOVËS KOMUNA E DRENASIT DRENAS MUNICIPALITY		
07.09.2023		
05	070/01	45147



REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Drenasit
Drejtoria për Zhvillim Ekonomik

FORMA E APLIKACIONIT PËR PERKRAHJE FINANCIARE – 2023

ANEKSI: A

I. INFORMATAT E PËRGJITHSHME TË APLIKANTIT	
1. Emri dhe Mbiemri:	Sabahate Gashi
2. Datëlindja:	07.08.1978
3. Gjinia:	☒ Femër ☐ Mashkull
4. Numri personal:	1030432513
5. Vendbanimi:	KOMORANI
6. Profesia:	Pasigjere
7. Numri telefonit:	049-216663
8. E-mail adresa:	sabahategashi31@gmail.com
II. INFORMATAT E PËRGJITHSHME TË BIZNESIT	
Posedoni biznes	Po/Jo
10. Emri i Biznesit:	
11. Numri unik i regjistrimit:	Nr. Regjistrimit: _____
12. Statusi Legal i Biznesit:	☐ Biznes Individual ☐ SHPK ☐ tjetër _____

13. Pronari (ët), Përfaqësuesi (t) ligjor:	
14. Adresa e Biznesit:	
15. Personi i Autorizuar ligjor:	
16. Emri i Bankës, Xhirollogaria e Biznesit:	

III. PËRSHKRIMI I SHKURTËR I PROJEKTIT/PLANIT TË BIZNESIT
17. Përshkruani gjendjen e tanishme të Biznesit tuaj : Për momentin nuk kam biznes të hapur, sepse nuk i kam mjetet e duhura për hapjen e një biznesi. Për ata edhe kam aplikuar të mënclihmoni që tja filloj punes që kam qervoj Pune 10 vite si pastigene dhe fcajere.
18. Përshkruani idenë e Projektit/Planin e Biznesit Tuaj : Një mendojm që biznesin ta hapim ne komoran, zero me trefik të lartë ku ka akses të lehtë për të gjithë klientat dhe hapësirë të mjaftueshme për parking.
19. Çka planifikoni të prodhoni apo të përpunoni, çfarë shërbimesh do të ofroni: Një do të krijojmë një gamë të gjerë të ëmbelsirave dhe të picave me kualitet dhe shërbim të lartë. Do të sigurohemi që të kem llogjishmëni shërbim që secili klientë të jetë i kënaqur me punet tona.

Llojet e produkteve dhe shërbimeve që bëni:
1. <i>TOGETE.</i>
2. <i>Pica.</i>
3. <i>Pagage.</i>
4.
5.

PËRFITUESIT
Numri i të punësuarëve si rezultat i Grantit:
1. <i>1. Ndihmese.</i>
2. <i>1. Mirëmbajtëse për higjienë.</i>

REZULTATET E PRITSHME NGA GRANTI:
Cfarë pritni të realizoni me mjetet financiare nga GRANTI?
1. <i>Do investojm në pajisje që do na ndihmojnë në prodhimin e bontes, Pica.</i>
2. <i>Marketing dhe promovim të cilin do ta shfrytëzojm që për të tjerë.</i>
3. <i>Do të investojm në ambientin e lokalit tonë për të ofruar klientin higjien dhe rehati.</i>

20. Zhvillimi Biznesit tuaj:
KLIENDET E BIZNESIT
Kush janë klientët tuaj?
1. <i>Gjyatarët e KEMERANIT.</i>
2. <i>Kalimtarët e rastit.</i>

Plani Marketingut
Ku dhe Si do t'i promovoni prodhimet/produktet apo shërbimet e juaja?
1. <i>Mediat sociale dhe marketingu online për të ofruar një prezenc në internet dhe për të ofruar klientët për eksportat tona.</i>

2.

21. Përshkruani strukturën organizative të biznesit tuaj:	
Punonjës me orar të plotë / nëse keni sa janë?	2
Punonjës me kohë të pjesëshme/ nëse keni sa janë?	0
Praktikantët - Punonjësit e rinjë/ nëse keni sa janë?	1

22. A jeni përfitues nga skema e Granteve Komunale paraprahe gjatë vitit të kaluar nga DZHE?	
☐ PO	☒ JO

23. A keni marrë ndonjë fond nga burime/organizata tjera?		☐ PO	☒ JO
Nëse PO ju lutem plotësoni te dhënat e mëposhtme			
Emri i Donatorit			
Shuma e përfituar në Euro			
Viti përfitimit të fondit			

24. Pajisjet, makineria, mjetet e punës të kërkuara përmes këtij projekti:				
Emri i pajisjes, mjetit të punës	SPECIFIKACIONI (Modeli, lloji, furnizuesi, karakteristikat teknike, viti i prodhimit, etj.)	Çmimi për njësi	Sasia kërkuar	Vlera totale EURO
Mikseri	Donatorit shantë 700W		1	726.55 €
Pompe për ujë 58mm	22. 24. 27. 30.		1	633.10 €
Pompe për ujë 22mm	12. 10.		1	303.10 €

Vlera totale e projektit:				

Burimet Financiare:	Shuma (€)	%
Kontributi personal	343.6	20%
Granti Komunal	1,374.4	80%
Kredi Bankare		
Tjera (specifiko)		
Shuma Totale	1,718.0	100%

Vërejtje: Në tabelat e mësipërme, mund të shtohet numri i kolonave sipas nevojës

DEKLARATË

Unë Sahabate Gashi deklaroj se informacionet e paraqitura në këtë kërkesë janë të plota, të besueshme dhe të vërteta, si dhe të mbështetura nga dokumentet përkatëse adekuate të cilat mund të verifikohen.

Po ashtu, unë DEKLAROJ se do të participoj sipas thirrjes publike.

Nënshkrimi:

Gashi

(Emri, Mbiemri dhe Nënshkrimi)

Datë:

07.09.2023

**KULINARE SHPK**

Nr. Fiskal : 810115718

Nr. TVSH : 330387672

NRB : 810115718

Adresa : Magj. Prishtine-Ferizaj

Selia : Gracanice

Tel / Fax : 045 99 33 66 /

Llog. bank : /

E-mail: info@kulinare.com

WEB: www.kulinare.com

BLERËSI : Qytetaret

Nr. FISKAL : 90000000

NRB :

SELIA: Prishtine

ADRESA :

TEL :

Nr. TVSH :

SHIFRA : 90000000

PROFATURA Nr.:916/23

E DATËS : 06.09.2023

DEPARTAMENTI : KULINARE

Nr.	KODI	EMËRTIMI	SASIA/ Nj.m.	CM. SHIT. PA TVSH	VLERA	LEJIMI	TVSH	CM. SHIT. ME TVSH	VL. SHIT. ME TVSH
1	H-CPM800	Mikser planetar 8lit, shpejtesi variabile, 800W	1 cop	707.63	707.63	7 %	118.457	776.55	776.55
2	251027	Prerese perimeve me 5 thika (Z3, Z4, Z7, E2,	1 cop	582.37	582.37	7 %	97.489	639.10	639.10
3	251032	Prerese pershute 22cm, 120W	1 cop	276.27	276.27	7 %	46.248	303.18	303.18
GJITHËSEJ SHITJET :					1,566.271	109.639	262.19		1,718.83

JU LUTEM QË KUR BËNI PAGESAT TË SHËNONI EDHE NR. E PROFATURËS TUAJ : 916/23

Sebahate Gashi
049 216 663

PRANOI/DATA :

FATUROI :



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Drenasit
Zyra e Kryetarit



01 Nr 400101-59970 dt. 18/12/2023

Në bazë të nenit 50 paragrafi 1 të Ligjit për Procedurën Administrative, Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, Statutit të Komunës së Drenasit, Rregullorës 12 Nr.320-19338, të dt.07.04.2017, për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e ndarjes së Subvencioneve, si dhe rregulloren Nr.02-400/01-18380 të dt; 27.04.2022, Buxheti i miratuar nga Kuvendi i Komunës së Drenasit për vitin 2023, Kryetari i Komunës paraqet këtë:

PROPOZIM

PËR NDRYSHIM/KORIGJIM TË VENDIMIT PËR FINANCIMIN E PROJEKTIT

- I. **KORIGJOHET** pika 2 e Vendimit me Nr: 01 Nr:400/01/-50470 të dt: 11.10.2023 konkretisht përlllogaritja e shumës për përkrahje: 1,600.00 €.
- II. **CAKTOHET** - Projekti Doruntina Shehu përkrahet me shumën prej **1,358.56 €** (njëmijë e treqindë e pesëdhjetë e tetë euro e pesëdhjetë e gjashtë cent) të cilat mjete do të shfrytëzohen për mbulimin e shpenzimeve-blejën e paisjeve, në vend të shumës prej: 1,600.00€.
- III. **KORIGJOHET** pika 3 e Vendimit, ndryshohet pjesa e tekstit: ndërsa transferi do të bëhet në xhirollogarinë me **nr. 1952005135031185 B.K.T.** të përfituesit në vend të textit, ndërsa transferi do të bëhet përmes xhirollogarisë me nr.XK051401000003002620 Banka Ekonomike.

Korrigjimi/Ndryshimi bëhet në përlllogaritje të shumës për përkrahje pasi që vërehet një mospërputhje mes kërkesës së shumës së projektit dhe shumës së llogaritur për përkrahje/subvencionim si dhe numrit të llogarisë bankare të përfituesit.


- IV. Pikat tjera të vendimit me Nr: 01 Nr:400/01/-50470 të dt: 11.10.2023 mbeten të pa ndryshuara.



Kryetari i Komunës
Ramiz Lladrovci



PRANJAR	11/11/23
N. Org.	21-400/11-52470



REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA DRENAS
Zyra e Kryetarit

Në vështrim të nenit 58, paragrafi 1, nënparagrafi h të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 34.6 të Statutit të Komunës së Drenasit, Rregullorës 12 Nr.320-19338, të dt.07.04.2017, për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e ndarjes së Subvencioneve, si dhe rregulloren Nr.02-400/01-18380 të dt.27.04.2022, Buxheti i miratuar nga Kuvendi i Komunës së Drenasit për vitin 2023. Me propozim të Komisionit për Shqyrtimin dhe Vlerësimin e kërkesave për ndarje të subvencioneve 01Nr.400/01-47695 e dt.22.09.2023, përmes thirrjes publike Nr.05-400-44432 të dt.04.09.2023, Kryetari i Komunës paraqet këtë:

PROPOZIM
VENDIM PËR FINANCIMIN E PROJEKTIT

Neni 1

Propozohet mbështetja me mjete financiare për projektin/programin e **Dorentina Shehu për** mbështetje financiare për mbulimin e shpenzimeve-blerjën e paisjeve.

Neni 2

Projekti i Dorentina Shehu përkrahet me shumën prej **1.600.00 €** (njëmijë e gjashtëqind euro) të cilat mjete do të shfrytëzohen për mbulimin e shpenzimeve-blerjën e paisjeve.

Neni 3

Mjetet financiare për realizimin e këtij projekti të lejohën nga kategoria ekonomike e shpenzimeve, subvencioneve dhe transfereve, kodi ekonomik 21/611/48001/21200/00000/0411 të Drejtoratit për Zhvillim Ekonomik të Komunës ndërsa transferi do të bëhet përmes xhirollogarisë me nr.XK051401000003002620 Banka Ekonomike.

Neni 4

Ky propozim vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Drenasit dhe vlerësimi të ligjshmërisë nga ana e MAPL-së. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset : Kryetari i Komunës, Drejtoria për Buxhet dhe Financa dhe Drejtoria për Zhvillim Ekonomik .



Kryetari i Komunës
Ramiz Lladrovci

Arsyetim

Bazuar në thirrjen publike Nr.05-400-44432 të dt.04.09.2023 nga Drejtoria për Zhvillim Ekonomik për ndajën e subvencioneve për Mikro biznese dhe Start-Up vitin 2023,projekti-kërkesa nr:05-070/01-46199 e dt.13.09.2023 për Dorentina Shehu me nr.personal 1245004105 për mbështetje financiare për mbulimin e shpenzimeve-blerjën e paisjeve.

Me propozim të Komisionit për Shqyrtimin dhe Vlerësimin e kërkesave për ndarje të subvencioneve, Kryetari i Komunës propozon Kuvendit përkrahjën me mjete financiare për biznesin ose personin në realizimin e projektit për mbështetje financiare për mbulimin e shpenzimeve-blerjën e paisjeve , në shumën prej 1.600.00 Euro.



REPubLIKA E KOSOVËS
Komuna e Drenasit
Drejtoria për Zhvillim Ekonomik



FORMA E APLIKACIONIT PËR PERKRAHJE FINANCIARE – 2023

ANEKSI: A

I. INFORMATAT E PËRGJITHSHME TË APLIKANTIT	
1. Emri dhe Mbiemri:	Dorantina Shehu
2. Datëlindja:	20.01.2000
3. Gjinia:	☒ Femër ☐ Mashkull
4. Numri personal:	4245006105
5. Vendbanimi:	Debrashoc
6. Profesioni:	Erimere dhe stiliste e thënie
7. Numri telefonit:	049-599-914
8. E-mail adresa:	tina_shehu@live.com
II. INFORMATAT E PËRGJITHSHME TË BIZNESIT	
Posedoni biznes	Po/Jo
10. Emri i Biznesit:	
11. Numri unik i regjistrimit:	Nr. Regjistrimit: _____
12. Statusi Legal i Biznesit:	☐ Biznes Individual ☐ SHPK ☐ tjetër _____

13. Pronari (ët), Përfaqësuesi (t) ligjor:	
14. Adresa e Biznesit:	
15. Personi i Autorizuar ligjor:	
16. Emri i Bankës, Xhirollogaria e Biznesit:	

III. PËRSHKRIMI I SHKURTËR I PROJEKTIT/PLANIT TË BIZNESIT
17. Përshkruani gjendjen e tanishme të Biznesit tuaj :
18. Përshkruani idenë e Projektit/Planin e Biznesit Tuaj : - Unë planifikoj të hapë një biznes pro personal, me të cilin mendoj të ofroj shërbime si : grim, pedikyr dhe manikyr, për të cilat jam cert certifikuar nga Shkolla Profesionale Gjermane dhe Ibc noils në Prishtinë. Besojë se jam e gatshme të ofroj shërbime si grimi profesional tek klientët dhe po ashtu shpresoj për mbështetje nga komuna ime.
19. Çka planifikoni të prodhoni apo të përpunoni, çfarë shërbimesh do të ofroni: - Planifikoj të ofroj shërbime për grime femërore si : grim, mbjellje dhe trajtim të thonjëve si dhe mbjelljen e gërpikëve në të cilinmën ku lokalin do ta marrë me qera në mbështetjen time financiare si dhe në mbështetje të familjes sime.

Llojet e produkteve dhe shërbimeve që bëni:
1. Make-up
2. Manikyr
3. Pedikyr
4. Mbjellje të gërbëve
5.

PËRFITUESIT
Numri i të punësuarëve si rezultat i Grantit:
1. Vetëpunësim
2. 1-2 punëtorë, 1-2 praktikantë (varësisht nga intensiteti i punës)

REZULTATET E PRITSHME NGA GRANTI:
Çfarë pritni të realizoni me mjetet financiare nga GRANTI?
1. Të hapë biznesin
2. Të pajisim me mjetet adekuate dhe cilësore për bërje shërbimesh
3. Rritje biznesi dhe varësisht nga bja të rritet edhe nr. i të punësuarve.

20. Zhvillimi Biznesit tuaj:
KLIENTET E BIZNESIT
Kush janë klientët tuaj?
1. Grupet e ndryshme, kryesisht gjinia femërore.
2. Personat të biznesit, mediat, reklamuesit dhe atyre parancuesit.
Plani Marketingut
Ku dhe Si do t'i promovoni prodhimet/produktet apo shërbimet e juaja?
1. Përmes TV, Radio, Postereve

2. Rrjetet sociale : Instagram, Tik Tok, Facebook etj.

21. Përshkruani strukturën organizative të biznesit tuaj:

Punonjës me orar të plotë / nëse keni sa janë?

Pronarja 1 (një)

Punonjës me kohë të pjesëshme/ nëse keni sa janë?

Rrjetore 1 ose 2

Praktikantët - Punonjësit e rinjë/ nëse keni sa janë?

1 ose 2 praktikantë

22. A jeni përfitues nga skema e Granteve Komunale paraprake gjatë vitit të kaluar nga DZHE?

☐ PO

☒ JO

23. A keni marrë ndonjë fond nga burime/organizata tjera?

☐ PO

☒ JO

Nëse PO ju lutem plotësoni te dhënat e mëposhtme

X

Emri i Donatorit

Shuma e përfituar në Euro

X

Viti përfitimit të fondit

X

24. Pajisjet, makineria, mjetet e punës të kërkuara përmes këtij projekti:

Emri i pajisjes, mjetit të punës	SPECIFIKACIONI (Modeli, lloji, furnizuesi, karakteristikat teknike, viti i prodhimit, etj.)	Çmimi për njësi	Sasia kërkuar	Vlera totale EURO
Kanale R PVCX levëse	P020	99.00	5.00	495.00
Lion për lampionin e thonjeve	D-222-1 65 W	121.60	2.00	243.20
Lampë për thonjë	256 W	29.00	4.00	116.00
Pajisje për plotues thonje	514X-858-G 40 W	39.00	2.00	78.00
Lampë tavoline	Led	49.00	2.00	98.00
Drile dyshe për foto	Led 24 W	99.00	1.00	99.00

Stenliuvas	FMX-75E01 SCOW	44.00	1.00	1.9.00
Tovoline	Biorba	6240.00	2.00	480.00
Vlera totale e projektit:				1.698.20 €

Burimet Financiare:	Shuma (€)	%
Kontributi personal	339.64	20 %
Granti Komunal	1358.56	80 %
Kredi Bankare		
Tjera (specifiko)		1,698.20 €
Shuma Totale		

Vërejtje: Në tabelat e mësipërme, mund të shtohet numri i kolonave sipas nevojës

DEKLARATË

Unë Dorantina Shehu deklaroj se informacionet e paraqitura në këtë kërkesë janë të plota, të besueshme dhe të vërteta, si dhe të mbështetura nga dokumentet përkatëse adekuate të cilat mund të verifikohen.

Po ashtu, unë DEKLAROJ se do të participoj sipas thirrjes publike.

Nënshkrimi:

Shehu

(Emri, Mbiemri dhe Nënshkrimi)

Datë:

13.09.2023



23-PSV01-001-69

PINK SH.P.K
RR. Nena Tereze 183/4 Fushe Kosove
N.U.I.: 811971961 Nr.TVSH:330530627
Tel: 045702020 / 049264888
Mail: Info@pink-pro.al
PCB: 1110345042000119

Oferta dergohet ne:

Malli dergohet ne:

DORENTINA SHEHU

Adresa: QENDER

Qyteti: Drenas

Telefoni: 049599914

No fiskal: 2261

Numri unik: 2261

11.09.2023

11.09.2023

001

1	5928	KARRELE PVCX LEVIZESE P020	5.00	Copë	83.90	0.00	18.00	99.00	495.00
2	2616	LIM PER LIMIMIN E THONJVE D-222-1 65W	2.00	Copë	120.00	0.00	18.00	141.60	283.20
3	7738	SUN C4 UV LLAMPE PER THONJE 256W	4.00	Copë	24.58	0.00	18.00	29.00	116.00
4	2480	ASPIRATOR PER PLUHUR TE THONJVE SMX-858-6 40W	2.00	Copë	33.05	0.00	18.00	39.00	78.00
5	2894	LED LLAMP TAVOLINE	2.00	Copë	41.53	0.00	18.00	49.00	98.00
6	5543	LED DRITE DYSHE PER FOTO 24W	1.00	Copë	83.90	0.00	18.00	99.00	99.00
7	6677	STERILIZATOR FMX-75E01 500W "FMX75E01"	1.00	Copë	41.53	0.00	18.00	49.00	49.00
8	5340	TAVOLIN BIURKA	2.00	Copë	203.39	0.00	18.00	240.00	480.00

Vlera pa TVSH : 1,439.15

Rabati : 0.00

TVSH : 259.05

Vlera per pagese: 1,698.20 EUR

Pergatiti:

Pranoi:

PCB: 1110345042000119



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Zyra e Kuvendit



Komisioni për shqyrtimin e Konkursit
02 Nr. 111 60732 dt. 19.12.2023

NJOFTIM

Komisioni për shqyrtimin e konkursit dhe zhvillimin e procedurave për formimin e Komitetit për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport, ju njofton me listën përfundimtare të kandidatëve që e kanë kaluar intervistën me gojë dhe numrin e pikëve.

Lista e kandidatëve për Komitetin Konsultativ për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport

Nr.	Emri Mbiemri	Vendbanimi	Nr. i Protokolit	Pikët e arritura në intervistë
1.	Leordita Shabani	Shtrubullojë	12-111/01-58739	60 pikë
2.	Avni Mehani	Gllanasellë	12-111/01-58399	55 pikë
3	Teuta Gashi	Llapushnik	12-111/01-58442	55 pikë
4	Lulzim Ademi	Dobroshec	12-111/01-58102	53 pikë
5.	Xhensika Gashi	Llapushnik	12-111/01-58735	51 pikë

Kandidatët e pakënaqur kanë të drejtë ankese në afatin prej 8 ditësh në Komisionin për Zgjedhjen e Kontesteve dhe Ankesave në Komunën e Drenasit, nga dita e shpalljes së rezultateve përfundimtare.



Kryesuesi Komisionit

Agim Kastrati
Agim Kastrati



REPUBLIKA E KOSOVËS
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna Drenas/Gllogoc
02-111/01-59046 dt:20.12.2023

Në bazë të vendimit nr.02-020/04-57200 të datës 22.11.2023 të Kryesuesit të Kuvendit Komunal, Komisioni për vlerësimin dhe shqyrtimin e aplikacioneve të kandidatëve që kanë konkurruar në konkursin për formimin e Komitetit Konsultativ Komunal për Zhvillim Ekonomik, Mbrojtje të Ambientit, Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, në bazë të raportit vlerësues me nr.02-111/01-59046 dt: 15.12.2023 rekomandon listën me anëtarët për Komitetin Konsultativ Komunal për Zhvillim Ekonomik, Mbrojtje të Ambientit, Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale në këtë përbërje:

Nr.	Emri dhe mbiemri	Nr.i aplikacionit	Kualifikimi	Vendbanimi
1.	Betim Morina	02-111/01-58194	Ekonomik	Dobroshec
2.	Lirie Bardhi	02-111/58743	Juridik	Drenas
3.	Arbenitë Rama	02-111/01-58215	Shkenca Komp.	Krajkovë
4.	Qëndresë Bardhi	02-111/01-58741	Juridik	Drenas
5.	Xheneta Hoxha	02-111-58740	Juridik	Korroticë

Drenas :20.12.2023



Kryesuesja e Komisionit



REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA GLLOGOC
Zyra e Kuvendit
Komisioni për Shqyrtimin e Konkursit
02 Nr. 02-020-57196, dt. 20/12/2023



NJOFTIM

Komisioni për shqyrtimin e konkursit dhe zhvillimin e procedurave për formimin e Komitetit Konsultativ: Komiteti për Persona me Aftësi të Kufizuar, ju njofton me listën përfundimtare të kandidatëve që e kanë kaluar intervistën me gojë dhe numrin e pikëve.

Lista e kandidatëve për Komitetin Konsultativ për Persona me Aftësi të Kufizuar

Nr.	Nr.protokollit	Emri dhe mbiemri	Pikët e arritura në intervistë
1	02-111/01-57173	Lendita Elshani	65 pikë
2	02-111/01-58234	Leonora Shala	61 pikë
3	02-111/01-58428	Mirlindë Gashi Xhylani	57pikë
4	02-111/01-57452	Deshira Berisha Morina	55 pikë
5	02-111/01-57441	Antigona Bucolli	55 pikë
6	02-111/01-58788	Indire Olluri Thaçi	53 pikë
7.	02-111/01-58745	Altesa Bytyqi	51 pikë

Kandidatët e pakënaqur kanë të drejtë ankese në afatin prej 8 ditësh në Komisionin për Zgjedhjen e Kontesteve dhe Ankesave në Komunën e Drenasit, nga dita e shpalljes së rezultateve përfundimtare.



Kryesuesi i Komisionit:

Zahrie Podrimqaku Subashi



Republika e Kosovës

Komuna e Drenasit

Zyra e Kryetarit

REPUBLIKA E KOSOVES			
KOMUNA GLLOGOC			
GLLOGOC MUNICIPAL			
PRANUAR 19 12 23			
Nj. Org.	Numër	Shtojca	Vlera
01-409/03-		60910	

Informimi i Kuvendit Komunal për aktivitetet e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi nga kryesuesi i KKSBB-së për gjashtëmujorin e dytë

Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi funksionon duke u bazuar në Udhëzimin Administrativ Nr27/2012 MPB-03/2012 MAPL për Këshillat Komunal për Siguri në Bashkësi. Sipas udhëzimit administrativ Nr.27/2012 MPB-03/2012 MAPL për Këshillat komunale për Siguri në Bashkësi, neni 9 Detyrat dhe Përgjegjësitë e kryesuesi të KKSBB-së, pika 1.8 është e obliguar të bëhet informimi i Kuvendit Komunal për aktivitetet e KKSBB-së.

Duke u bazuar në këtë udhëzim administrativ, ju informoj se në fillim të vitit 2023 me qëllim të realizimit të detyrave operative lidhur me çështjet e Sigurisë në Bashkësi, në mbështetje të nenit 7 të Ligjit nr.04/01-076, për Policinë, nenit 11, pika 2 e udhëzimit administrative nr.27/2012 MPB-03/2012 MAPL, për KKSBB-në, është caktuar orari i punës, ku janë paraparë gjashtë (6) takime të rregullta të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi.

Duke u bazuar në nenin 11, pika 2, ku thuhet “KKSBB-ja mban më së paku gjashtë (6) mbledhje në vit, tri (3) prej se cilave duhet të mbahen në gjashtë mujorin e parë të vitit kalendarik dhe tri në gjashtëmujorin e dytë, Komuna e Drenasit i është përmbajtur duke mbajtur gjashtë mbledhje të rregullta gjatë vitit 2023.

Në gjashtëmujorin e dytë për të cilin po informojmë, janë mbajtur tri takime të cilat janë thirrur 7 ditë para mbajtjes së takimit dhe janë publikuar në ueb faqen e komunës së Drenasit. Në këto takime janë diskutuar çështje të cilat lidhen me sigurinë në bashkësi në Komunën e Drenasit, si siguria e ambientit, siguria shëndetësore, siguria rrugore dhe propozime të tjera që kanë dal nga anëtarët e KKSBB-së.

Në mbledhje janë ftuar anëtarët e KKSBB-së dhe monitorues, të cilët janë evidentuar në Listën e Pjesëmarrjes. Në tabelën e mëposhtme të përmbledhur gjeni takimet, temat dhe adresimi i tyre.

Data e Mbledhjes	Temat e diskutuara	Adresimi/Përgjegjësit
03.08.2023 Linku: https://kk.rks-gov.net/gllogoc/wp-content/uploads/sites/10/2023/10/Ftesa-dhe-procesverbali-i-KKSB-03.08.2023.pdf	2. Procesverbali i mbledhjes së rregullt të KKSB-së të mbajtur me datë 18.05.2023 https://kk.rks-gov.net/gllogoc/wp-content/uploads/sites/10/2023/06/KKSB-Procesverbali.pdf 3. Raport lidhur me zjarret fushore dhe malore nga NJPZSH-ja; 4. Masat e sigurisë për Muajin e Mërgatës; 5. Aksidentet në trafik, raport nga Stacioni Policor në Drenas 6. Të ndryshme	Mbledhje të ekzekutivit/Koordinatori i KKSB-së/Drejtorët
26.10.2023 Linku: https://kk.rks-gov.net/gllogoc/wp-content/uploads/sites/10/2023/10/Ftesa-per-mbledhjen-KKSB-se-2023.pdf	1. Procesverbali i mbledhjes së rregullt të KKSB-së të mbajtur me datë 03.08.2023 https://kk.rks-gov.net/gllogoc/wp-content/uploads/sites/10/2023/10/Ftesa-dhe-procesverbali-i-KKSB-03.08.2023.pdf; 2. Gjendja me zjarre fushore-malore në Komunën e Drenasit; 3. Tetori- Muaji i ndërgjegjësimit kundër kancerit të gjirit; 4. Fushata Vetëdijuese në Parandalimin e Trafikimit me Qenie Njerëzore 5. Të ndryshme;	Mbledhje të ekzekutivit/Koordinatori i KKSB-së/Drejtorët
30.11.2023 Linku: https://kk.rks-gov.net/gllogoc/wp-content/uploads/sites/10/2023/11/FTESA-per-mbledhjen-e-gjashte-te-KKSB-se.pdf	1. Procesverbali i mbledhjes së rregullt të KKSB-së të mbajtur me datë 26.10.2023 https://kk.rks-gov.net/gllogoc/wp-content/uploads/sites/10/2023/11/Proces	Mbledhje të ekzekutivit/Koordinatori i KKSB-së/Drejtorët

	verbal-i-mbledhjes-se-mbajtur-me-date-26.10.2023-3.pdf 2. Fushatat e organizuara nga KNJKDNJ, ZBGJ nëpër shkolla lidhur me “Trafikimin me qenie njerëzore” dhe përgatitjet për fushatën ”16 Ditë të Aktivizimit Kundër Dhunës në Bazë Gjinore” . 3. Vaksinimi i qenve shtëpiak dhe qenve endacak; 4. Të ndryshme	
--	--	--

- ✓ Përveç KKSB-së janë mbajtur Këshillat Lokal për Sigurinë Publike ashtu siç parashihet me udhëzim administrativ gjithsej 3 takime të kryesuara nga kryesuesi i KLSP-së. Në këto takime janë diskutuar tema që lidhen me sigurinë, me praninë edhe zyrtarëve policor.
- ✓ Në gjashtëmuorin e dytë kemi raportuar në Divizionin për Siguri Publike në Ministrinë e Punëve të Brendshme për veprimet, masat dhe iniciativat e ndërmarra nga komuna në realizimin/adresimin e sfidave të paraqitura gjatë mbledhjeve për periudhën Janar-Nëntor 2023.
- ✓ Kemi hartuar Planin e Punës dhe Orarin e mbledhjeve për vitin 2024, i cili do të përcillet për miratim në asamblenë komunale pas miratimit në KKSB.



Kryetari i komunës

Ramiz Lladrovci

REPUBLIKA E KOSOVËS			
KOMUNA GLLOGOC			
GLLOGOC MUNICIPALITY			
PRANUAR	19	12	2023
Nj. Org.	Numër	Shtojca	Vlera
02	052/01	60889	



Republika e Kosovës
Komuna e Drenasit



**Kuvendi
Komiteti për Komunitete**

PROPOZIM

**Komiteti për Komunitete me qëllim të realizimit të
detyrave të punës në përputhje me Rregulloren e
Punës së Komiteteve të Komunës së Drenasit dhe
Ligjin për Vetëqeverisje Lokale harton këtë:**

Raport të punës për vitin 2023

Hyrje

*Komiteti për Komunitete është organ i formuar nga
Kuvendi i Komunës së Drenasit në harmoni me Statutin e
Komunës dhe Rregullores së punës së Kuvendit.*

Misioni:

*Siç është përshkruar në Ligjin për Vetëqeverisje Lokale
Komiteti për Komunitete është përgjegjës për të trajtuar
çfarëdo çështje që ka të bëjë me diskriminimin e një
personi mbi çfarëdo baze siç është: gjuha, religjioni,
prejardhja etnike, dhe çdo çështje tjetër që lidhet me
interesin e një komuniteti.*

*Komiteti për Komunitete përbëhet gjithsej 5 anëtarë , në
komitet është një përfaqësues i subjektit politik PDK një
përfaqësues i subjektit politik DD një përfaqësues i
subjektit politik LVV, një përfaqësues i Komunitetit të
Bizneseve dhe një përfaqësues i OJQ -së.*

Puna dhe Aktivitetet

*Gjatë vitit 2023 Komiteti për Komunitetë ka mbajtur 6
mbledhje të rregullta.*

*Në të gjitha mbledhjet ka mbizotëruar frymë e mirë
bashkëpunimi dh janë trajtuar çështje të rëndësishme.*

Në fillim të muajit Shkurt 2023 është mbajtur mbledhja e parë për këtë vit ku temë e diskutimit ishte "Plani i Punës për vitin 2023", pasi secili nga anëtarët ka dhënë idetë e tyre lidhur me këtë plan, me vota unanime është miratuar Plani i Punës për vitin 2023 si dhe është caktuar orari i mbledhjeve të planifikuara përgjatë vitit.

Në muajin Maj komiteti ka mbajtur një mbledhje ku temë diskutimi ishte "Gjendja e Arsimit në Komunën e Drenasit", për të diskutuar për këtë temë ishte i ftuar Drejtori i Arsimit në komunën e Drenasit z. Muhamet Gjoka, anëtarët e komitetit i kanë parashtruar pyetje dhe sugjerime z. Gjoka lidhur me çështjet me të cilat përballet arsimi në komunën tonë. Temë tjetër në këtë mbledhje ishte "Raport nga Zyra për Komunitete dhe Kthim në Komunën e Drenasit", ku për të diskutuar për këtë temë ishte prezente znj. Afije Veseli. Znj. Afije para anëtarëve raportoi për punën dhe aktivitetet e kësaj zyre.

Në mbledhjen e mbajtur në muajin Qershor temë diskutimi ishte: "Gjendja me Vërshimet në Komunën e Drenasit", i ftuar për të diskutuar për këtë temë ishte Drejtori i Shërbimeve Publike në komunën e Drenasit z. Nexhmedin Gruda. Z. Gruda bashkë me anëtarët diskutuan për gjendjen pas vërshimeve në komunën e tonë.

Në mbledhjen e mbajtur në muajin Shtator, për të raportuar nga Zyra për Komunitete dhe Kthim në komunën e Drenasit ishte e pranishme znj. Afije Veseli.

Në mbledhjen e mbajtur në muajin Tetor, për të diskutuar për temën "Inspektimi i Bizneseve në komunën e Drenasit" ishte i ftuar drejtori i Inspektoriatit në komunën e Drenasit z. Petrit Sinani. Z. Sinani bashkë me anëtarët e komitetit diskutuan lidhur me punën e kësaj drejtorie me theks të veçantë inspektimin e bizneseve.

Në mbledhjen e fundit që u mbajt në muajin Nëntor, temë diskutimi ishte "Raport nga Zyra për Komunitete dhe Kthim"

dhe "Aktivitetet e Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport".
Raportin për mbledhjen e fundit para anëtarëve e paraqiti
znj. Afije Veseli.
Për të diskutuar për temën e dytë prezent ishte
perfaqësuesi i Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport zAgim
Kastrati.
Ai para anëtarëve tregoi për punën dhe aktivitetet e kësaj
drejtorie.

Përgjatë vitit, kryesuesi ka takuar qytetarë të
shumtë, problemet e të cilëve i ka adresuar edhe në
takimet e komitetit.

Drenas, Dhjetor 2023



Kryesuesi i Komitetit

Drin Halilaj



Republika e Kosovës

Komuna e Drenasit
Komiteti Konsultativ për Barazi Gjinore



02 Nr. 052/01-60996 dt. 20/12/2023

**Raporti vjetor i punës së Komitetit Konsultativ për Barazi Gjinore për vitin
2023**

Janar - Dhjetor, 2023

Hyrje:

- Anëtarët e përzgjedhur të Komitetit Konsultativ për Barazi Gjinore në Komunën e Drenasit gjatë periudhës **Janar- Dhjetor 2023**, kanë organizuar dhe mbajtur mbledhjet sa i përket këtij komiteti.

Gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2023, **KKBGJ** ka mbajtur disa takime, të cilat përpos diskutimeve në fund të secilit takim ka rezultuar një rekomandim drejtuar institucioneve përkatëse dhe komunës në Drenas (Gllogoc).

Në secilin takim janë shqyrtuar pika të veçanta dhe rendi i ditës ka qenë specifik për secilin takim të mbajtur. Secili takim është shoqëruar me proces verbal dhe raportimin adekuat.

Paraqitja e detajuar e shqyrtimit të pikave të rendit të ditës në mbledhjet e mbajtura të Komitetit për Barazi Gjinore gjatë periudhës janar-dhjetor 2023

Janar, 2023

Mbledhja e parë e rregullt e Komitetit Konsultativ për Barazi Gjinore është mbajtur me datën **13.01.2023**, ku janë shqyrtuar **(3)** tre pika të diskutimit dhe me këtë rend të ditës. Pas mbledhjes është përgatit raporti dhe rekomandimi i KKBGJ-së.

1. Planifikimi i takimeve të KKBGJ-së përgjatë vitit 2023.
2. Shqyrtimi i mundësisë së kyçjes së grave të pakualifikuara në tregun e punës ose kyçja e tyre në aktivitete shoqërore jashtë shtëpisë.
3. Të ndryshme.

Rekomandimi i mbledhjes së parë është:

Komuna e Drenasit, qoftë si punëdhënëse, qoftë si organizues i mundësive për punësim duhej të gjej mënyra për hapjen e mundësive për punësim duke rritur interesimin e grave dhe burrave për punë në sektorë të ndryshme përmes organizimit të trajnimeve/kurseve profesionale.

Ky rekomandim bazohet në ligjin për barazi gjinore Ligji Nr. 05/L-020, neni 17, pika 1.8, ku thuhet se punëdhënësi/ja duhet:

“të sigurojë që femrat dhe meshkujt të kenë mundësi të barabarta për të vazhduar shkollimin dhe aftësimin profesional dhe të përcjellin trajnimet të cilat mbahen për të shtuar shkathhtësitë profesionale ose të përgatiten për profesione të tjera”

Mbledhja e dytë e rregullt e Komitetit Konsultativ për Barazi Gjinore është mbajtur më: 06.03.2023, ku janë shqyrtuar (2) dy pika me këtë rend dite dhe nga ky takim po ashtu është nxjerr një rekomandim. Pas mbledhjes është përgatit raporti dhe rekomandimi e KKBGJ.

1. Siguria e lëvizjes në hapësira publike
2. Të ndryshme

Rekomandimi i mbledhjes se dytë është:

Qeveria lokale të sigurojë hapësira për lëvizje të sigurve të grave dhe vajzave, gjithashtu duhet të ndriçoj të gjitha zonat publike dhe të identifikoj zonat e pasigurta të lëvizjes së grave dhe vajzave në mënyrë që gratë dhe vajzat të ndihen të sigurve për të udhëtuar për në punë ose në aktivitete të tjera gjatë natës dhe mëngjeseve të hershme.

Ky rekomandim bazohet në (LIGJI Nr. 05/L -020 PËR BARAZI GJINORE), ku sipas nenit 3, pika 1.10 “Mundësi e barabartë - nënkupton sigurimin e pjesëmarrjes së plotë dhe të barabartë meshkujve dhe femrave në të gjitha aspektet e jetës politike, sociale, kulturore, arsimore, ekonomike dhe fushat tjera të përcaktuara me këtë ose ndonjë ligj tjetër.”

Mbledhja e tretë e rregullt e Komitetit Konsultativ për Barazi Gjinore është mbajtur më: 08.05.2023, ku janë shqyrtuar (2) dy pika me këtë rend dite dhe nga ky takim po ashtu është nxjerr një rekomandim. Pas mbledhjes është përgatitur raporti dhe rekomandimi i KKBGJ.

1. Përkrahja e grave shtatzëna dhe me fëmijë të vegjël në punësim
2. Të ndryshme

Rekomandimi i mbledhjes se tretë është:

Komuna e Drenasit të ndërtoj plane dhe strategji për luftimin e dukurisë së mospërkrahjes së grave shtatzëna dhe me fëmijë të vegjël në punësim. Kjo dukuri mund të luftohet qoftë përmes fushatave vetëdijesuese, qoftë përmes bashkëpunimit me firmat private dhe entit të punësimit, apo edhe duke inkurajuar firmat tatimpaguese që të punësojnë këto gra.

Ky rekomandim bazohet në (LIGJI Nr. 05/L -020 PËR BARAZI GJINORE nenit 3, pika 1.10).

Mbledhja e katërt e rregullt e Komitetit Konsultativ për Barazi Gjinore është mbajtur më: 05.09.2023, ku janë shqyrtuar (2) dy pika me këtë rend dite dhe nga ky takim po ashtu është nxjerr një rekomandim. Pas mbledhjes është përgatitur raporti dhe rekomandimi i KKBGJ.

1. Zbatimi i LIGJIT Nr.05/L -020 Për Barazi Gjinore, në rastin e emërimit të institucioneve, shkollave e rrugëve.
2. Të ndryshme


Rekomandimi i mbledhjes së katër i është dërguar Komisionit për Emërtimin e Rrugëve

Të kenë parasysh LIGJI Nr. 05/L -020 PËR BARAZI GJINORE, për emërtimin e rrugëve.

KKBGJ-ja jep rekomandin Komisionit për Emërtimin e Rrugëve të komunës së Drenasit që ta këtë parasysh ligjin Për Barazi Gjinore dhe që për emërtimin e rrugëve të bazohen edhe në këtë ligj, përkatësisht në **Neni 5 pika 1.9, te Ligji Nr. 05/L-020.**

1.9. “të marrë parasysh barazinë gjinore në rastin e emërimit të institucioneve, shkollave e rrugëve”.

Vendi i ynë ka vajza- heroina të shumta të cilat kanë jep kontribut të madh për vendin tone dhe emrat e të cilave e meritojnë të jenë edhe prezentë në emërtimet e rrugëve tona.

**Kryesues i KKBGJ**

Arton Hasani